



*102 vjet Shërbimi i
Shëndetësisë Shqiptare
Historia e një misioni që nuk
ka njohur kurrë pushim*



NJË SHEKULL NË SHËRBIM TË JETËS, KOMBIT DHE USHTARIT SHQIPTAR

» faqe 8



MINISTRI I MBROJTJES ERMAL NUFI INSPEKTON INVESTIMIN E "GUNA TACTICAL": NJË HAP STRATEGJIK PËR INDUSTRIJË SHQIPTARE TË MBROJTJES

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, së bashku me zëvendëskryeministren e Republikës së Shqipërisë, znj. Albana Koçiu, zhvilluan një vizitë inspektuese në kantierin e kompanisë "Guna Tactical", ku po ndërtohet një nga investimet më të rëndësishme në industrinë shqiptare të mbrojtjes. Gjatë vizitës u vlerësua ecuria e punimeve dhe rëndësia strategjike e projektit, i cili synon të krijojë një bazë...

faqe 3



KATËR VITE NËN FLAMURIN E NATO-s HISTORIA E SUKSESIT TË KAPITENIT TË RANGUT III, FATION CUFAJ

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në strukturat shumëkombëshe të NATO-s, ku profesionalizmi, përgjegjësia dhe aftësia për të bashkëpunuar në një mjedis ndërkombëtar janë vlera themelore, oficerët shqiptarë vazhdojnë të dëshmojnë se janë përfaqësues të denjë...

faqe 6



FUQIA E GRAVE QË FRYMËZON LIDERËT E BOTËS

Më shumë se bashkëshorte, gratë që ndërtojnë ura besimi. Në çdo Samit të NATO-s, kamerat ndjekin presidentët, kryeministrat, ministrat e mbrojtjes dhe komandantët ushtarakë. Objektivat fokusohen te vendimet për sigurinë, mbrojtjen kolektive, konfliktet dhe paqen. Në sallat ku merren vendime që ndikojnë fatin e miliona njerëzve, protagonizmi u takon liderëve. Por, jashtë tryezave të negociatave, ekziston një dimension tjetër i samitit. Një dimension më i qetë, më pak...

faqe 11

Shqipëria dhe Gjermania forcojnë partneritetin strategjik në mbrojtje

Vizita zyrtare në Shqipëri e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës Federale të Gjermanisë, Gjeneral Carsten Breuer, shënoi një tjetër hap të rëndësishëm në forcimin e marrëdhënieve strategjike mes dy vendeve aleate në NATO. Takimet e zhvilluara me ministrin e Mbrojtjes, Ermal Nufi, dhe me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, rikonfirmuan vullnetin politik dhe ushtarak për zgjerimin e bashkëpunimit në mbrojtje, rritjen e ndërveprueshmërisë dhe përbalimin e sfidave të reja të sigurisë.

Në takimin me ministrin e Mbrojtjes, Ermal Nufi, u vlerësuan marrëdhëniet e shkëlqyera mes Shqipërisë dhe Gjermanisë, si dhe kontributi i rëndësishëm i Berlinit në forcimin e sigurisë së NATO-s, stabilitetit të Ballkanit Perëndimor dhe mbështetjes së vazhdueshme për zhvillimin e kapaciteteve mbrojtëse shqiptare.

Ministri Nufi e cilësoi vizitën e Gjeneral Breuer si një mundësi të rëndësishme për zgjerimin e bashkëpunimit ushtarak dypalësh dhe për identifikimin e fushave të reja të partneritetit. Gjatë bisedimeve, palët trajtuan zhvillimet e sigurisë në rajon, sfidat e mjedisit strategjik ndërkombëtar dhe angazhimet e përbashkëta në kuadër të Aleancës Atlantike.

Një vend të rëndësishëm në diskutime zunë përgatitjet për Samitin e ardhshëm të NATO-s, që do të zhvillohet në Tiranë. Ministri Nufi theksoi se “Samiti do të jetë një moment historik për vendin dhe një mundësi për të dëshmuar se Ballkani Perëndimor është një kontribuues i rëndësishëm për sigurinë euroatlantike”.

Bashkëbisedimi u ndal edhe te modernizimi i industrisë shqiptare të mbrojtjes. Ministri prezantoi programin e qeverisë për zhvillimin e kapaciteteve prodhuese vendase, tërheqjen e investimeve strategjike dhe integrimin e Shqipërisë në zinxhirët evropianë të furnizimit të industrisë së mbrojtjes, duke shprehur interes për zgjerimin e bashkëpunimit me kompanitë gjermane në këtë sektor.

Një tjetër temë me rëndësi ishte zhvillimi i Korridorit VIII, i konsideruar një projekt strategjik jo vetëm për ndërlidhjen rajonale, por edhe për rritjen e mobilitetit ushtarak të NATO-s në krahun juglindor të Aleancës.

Në vijim të vizitës, Gjeneral Carsten Breuer u prit nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji. Gjatë takimit u rikonfirmua partneriteti i qëndrueshëm ndërmjet dy forcave të armatosura dhe angazhimi për zgjerimin e bashkëpunimit në arsimin ushtarak, stërvitjet e përbashkëta, trajnimet, zhvillimin e kapaciteteve dhe rritjen e ndërveprueshmërisë në kuadër të NATO-s.

Gjeneral Kingji shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme që Gjermania i ka dhënë Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura në procesin e modernizimit dhe zhvillimit profesional të personelit ushtarak.

“Kënaqësi e veçantë të mirëprisja në një vizitë zyrtare shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura Gjermane, Gjeneral Carsten Breuer. Rikonfirmuam partneritetin e qëndrueshëm dhe angazhimin e përbashkët për forcimin e bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes”, - u shpreh Gjeneral Kingji.



Ai theksoi gjithashtu se mbështetja gjermane në arsimin ushtarak, trajnimet, stërvitjet dhe zhvillimin e kapaciteteve ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në rritjen e profesionalizmit dhe gatishmërisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Vizita e Gjeneral Carsten Breuer konfirmoi edhe një herë se marrëdhëniet Shqipëri-Gjermani kanë hyrë në një fazë të re të bashkëpunimit strategjik, ku dialogu politik, bashkëpunimi ushtarak, zhvillimi i industrisë së mbrojtjes dhe angazhimi i përbashkët në NATO përbëjnë shtyllat kryesore të një partneriteti që kontribuon drejtpërdrejt në sigurinë e rajonit dhe të hapësirës euroatlantike.

Mesazhi i përbashkët i ministrit të Mbrojtjes Ermal Nufi dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjenerallejtënant Arben Kingji, ishte i qartë: Shqipëria dhe Gjermania mbeten aleatë të vendosur, të bashkuar nga vlerat e NATO-s dhe të përkushtuar për ndërtimin e forcave të armatosura moderne, të afta për t’iu përgjigjur sfidave të sigurisë së sotme dhe të së ardhmes.



Forca Tokësore dhe Turqia thellojnë bashkëpunimin ushtarak

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Petrit Çuni, zhvilloi një takim pune me Atasheun e Mbrojtjes të Republikës së Turqisë në Shqipëri, kolonel Tolga Kip, në kuadër të forcimit të bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes.

Gjatë takimit, bashkëbiseduesit diskutuan mbi zgjerimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndërmjet Forcës Tokësore të Republikës së Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë, me fokus zhvillimin e kapaciteteve ushtarake, stërvitjen, trajnimin e personelit dhe shkëmbimin e përvojave profesionale.

Gjeneralmajor Petrit Çuni vlerësoi nivelin e lartë të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve aleate në NATO, duke theksuar rëndësinë e partneritetit strategjik me Turqinë në rritjen e aftësive operationale dhe ndërveprueshmërisë së Forcave të Armatosura.

Nga ana e tij, Atasheu i Mbrojtjes i Republikës së Turqisë, kolonel Tolga Kip, shprehu gatishmërinë për vijimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit në fushat me interes të përbashkët, duke nënvizuar rëndësinë e programeve të përbashkëta të stërvitjes dhe trajnimit në forcimin e kapaciteteve ushtarake.



Në përfundim të takimit, të dyja palët vlerësuan partneritetin e shkëlqyer ndërmjet Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe Turqisë, duke riafirmuar angazhimin për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në funksion të objektivave të përbashkëta të Aleancës së Atlantikut të Veriut dhe për forcimin e sigurisë rajonale e euroatlantike.



Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi inspekton investimin e “Guna Tactical”: Një hap strategjik për industrinë shqiptare të mbrojtjes

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, së bashku me zëvendëskryeministren e Republikës së Shqipërisë, znj. Albana Koçi, zhvilluan një vizitë inspektuese në kantierin e kompanisë “Guna Tactical”, ku po ndërtohet një nga investimet më të rëndësishme në industrinë shqiptare të mbrojtjes.

Gjatë vizitës u vlerësua ecuria e punimeve dhe rëndësia strategjike e projektit, i cili synon të krijojë një bazë moderne prodhimi për pajisjet e mbrojtjes dhe të sigurisë, duke kontribuar njëkohësisht në zhvillimin ekonomik të vendit, hapjen e vendeve të reja të punës dhe rritjen e kapaciteteve kombëtare të mbrojtjes.

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, theksoi se investimi përfaqëson një hap konkret në zbatimin e vizionit të qeverisë për zhvillimin e industrisë shqiptare të mbrojtjes dhe integrimin e saj në tregjet ndërkombëtare.

“Guna Tactical’ po ndërton një fabrikë të specializuar për projektimin dhe prodhimin e veshjeve dhe aksesoreve për Forcat e Armatosura, Policinë e Shtetit, Policinë e Burgjeve, struktura të tjera të sigurisë, si dhe për partnerë nga vendet anëtare të NATO-s”, - u shpreh ministri Nufi.


Sipas tij, investimi pritet të krijojë rreth **1 200 vende të reja pune**, duke sjellë në Shqipëri teknologji moderne, ekspertizë të avancuar dhe standarde bashkëkohore të prodhimit. Ai nënvizoi se projekti synon të integrojë industrinë shqiptare të mbrojtjes në zinxhirët ndërkombëtarë të furnizimit, duke rritur konkurrueshmërinë e saj dhe duke forcuar pozicionin e Shqipërisë si një partner i besueshëm në hapësirën euroatlantike.

Ministri Nufi theksoi se zhvillimi i industrisë së mbrojtjes mbetet një nga prioritetet strategjike të qeverisë, me synimin për ta kthyer këtë sektor në një motor të rëndësishëm të zhvillimit ekonomik, inovacionit teknologjik dhe fuqizimit të sigurisë kombëtare.

“Investime të tilla dëshmojnë angazhimin për ndërtimin e një industrie shqiptare të mbrojtjes më të fortë, më konkurruese dhe të integruar ngushtë me partnerët strategjikë dhe aleatët e NATO-s”, - deklaroi ministri i Mbrojtjes.

Ndërtimi i fabrikës së “Guna Tactical” konsiderohet një investim me rëndësi të veçantë për konsolidimin e bazës industriale të mbrojtjes në Shqipëri. Projekti pritet të rrisë kapacitetet prodhuese vendase, të mbështesë furnizimin e institucioneve të sigurisë me produkte të standardeve ndërkombëtare dhe të krijojë mundësi të reja bashkëpunimi me partnerët e Aleancës Atlantike.

Vizita e Ministrit të Mbrojtjes dhe zëvendëskryeministres Koçi riafirmoi mbështetjen institucionale për investimet strategjike në industrinë e mbrojtjes, një sektor që po merr një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit dhe në forcimin e kapaciteteve kombëtare të sigurisë.



Bashkëpunimi ushtarak ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës vijon të forcohet përmes shkëmbimit të ekspertizës dhe zhvillimit të kapaciteteve profesionale. Instruktorë të Qendrës së Zhytjes së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me bazë në Pashaliman, zhvilluan një program trajnimi për pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), të fokusuar në misionet e kërkim-shpëtimit dhe operacionet e specializuara nënujore. Trajnimi u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet dy forcave, me synim rritjen e aftësive operacionale të personelit, shkëmbimin e përvojave profesionale dhe përmirësimin e procedurave të përbashkëta në operacionet nënujore.

Gjatë programit, efektivistët e FSK-së u njohën me teknikat dhe procedurat bashkëkohore të kërkim-shpëtimit, ndërhyrjes në mjedisin ujor dhe operacioneve të specializuara, nën drejtimin e instruktorëve shqiptarë, të cilët disponojnë eksperiencë të konsoliduar në këtë fushë. Ky aktivitet përfaqëson një tjetër dëshmi të partneritetit të ngushtë ndërmjet Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, duke kontribuar në rritjen e ndërveprueshmërisë, shkëmbimin e ekspertizës profesionale dhe përgatitjen e përbashkët për përbashkëtimin e misioneve dhe sfidave të sigurisë.

Përmes aktiviteteve të tilla stërvitore dhe trajnuese, dy institucionet ushtarake vijnë të konsolidojnë bashkëpunimin dypalësh, duke forcuar kapacitetet njerëzore dhe operacionale në funksion të sigurisë dhe stabilitetit në rajon.

Instruktorët shqiptarë trajnojnë pjesëtarët e FSK-së për operacionet e kërkim-shpëtimit nënujore



Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi dekoron me “Medaljen e Artë të Shërbimit Ushtarak” shefin e Grupit Ushtarak Amerikan në Shqipëri

Ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, i akordoi **“Medaljen e Artë të Shërbimit Ushtarak”** shefit të Grupit Ushtarak Amerikan në Shqipëri, nënkolonel Joshua A. Magnusson, në vlerësim të kontributit të tij të shquar në forcimin e partneritetit strategjik ndërmjet Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe për meritat e veçanta në realizimin dhe qëndrueshmërinë e programeve të bashkëpunimit ushtarak.

Ceremonia e dekorimit përkoi me përfundimin e mandatit të nënkolonelit Magnusson në drejtimin e Grupit Ushtarak Amerikan në vendin tonë, duke shënuar një moment vlerësimi për angazhimin dhe kontributin e tij në zhvillimin e marrëdhënieve të mbrojtjes mes dy vendeve aleate.

Në fjalën e tij, ministri Ermal Nufi vlerësoi partneritetin strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës si një nga shtyllat më të rëndësishme të sigurisë kombëtare të Shqipërisë.

“Është diçka që është thënë dhe që do të vijojë të thuhet, dhe sa herë të na jepet mundësia do ta themi përsëri: Partneriteti ynë me SHBA-të është një gur themeli i sigurisë sonë kombëtare dhe i qëndrimit tonë kombëtar. Akordojmë Medaljen e Artë për të gjitha shërbimet e tyre ndaj SHBA-ve dhe Shqipërisë. Është shumë e rëndësishme të vlerësohet një moment i tillë, të nderohen njerëzit që e kanë bërë të mundur këtë, që kanë kontribuar në këtë marrëdhënie, që e kanë forcuar atë dhe që kanë bërë të mundur që Forcat tona të Armatosura dhe vendet tona të qëndrojnë më të forta së bashku”, - u shpreh ministri Nufi.

Ministri i Mbrojtjes theksoi se bashkëpunimi me Shtetet e Bashkuara mbetet një element kyç në modernizimin e Forcave të Armatosura, rritjen e kapaciteteve operationale dhe zhvillimin e profesionalizmit të personelit ushtarak shqiptar, duke falënderuar nënkolonelin Magnusson për përkushtimin



dhe kontributin e tij gjatë mandatit në Shqipëri.

Në të njëjtën ceremoni, ministri Nufi i akordoi **Certifikatën e Mirënjohjes** edhe rreshterit amerikan Emmanuel Ebhoomhan, koordinator për operacionet pranë Zyrës së Atasheut Ushtarak të Shteteve të Bashkuara në Shqipëri, në shenjë vlerësimi për angazhimin dhe mbështetjen e vazhdueshme në forcimin e bashkëpunimit ushtarak ndërmjet dy vendeve.

Ceremonia ishte një dëshmi e marrëdhënieve të shkëlqyera mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, partneritet që vazhdon të kontribuojë në rritjen e aftësive të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe në forcimin e sigurisë në kuadër të Aleancës së Atlantikut të Veriut.

Kontingjenti VIII i Forcës Tokësore merr detyrën në misionin e NATO-s në Bullgari

Në bazën stërvitore **Novo Selo Training Area (NSTA)** u zhvillua ceremonia zyrtare e transferimit të detyrës ndërmjet Kontingjentit VII dhe Kontingjentit VIII të Forcës Tokësore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të angazhuar në kuadër të misionit **Forward Land Forces (FLF)** të NATO-s.

Gjatë ceremonisë, Kontingjenti VIII mori zyrtarisht përgjegjësinë për vijimin e misionit, ndërsa Kontingjenti VII përmbylli me sukses angazhimin e tij, duke dëshmuar gjatë gjithë periudhës së shërbimit profesionalizëm, disiplinë dhe përkushtim në përmbushjen e detyrave të besuara nga Aleanca. Rotacioni i kontingjenteve përfaqëson vazhdimësinë e kontributit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionet e NATO-s dhe riafirmon angazhimin e vendit tonë në mbështetje të mbrojtjes kolektive dhe sigurisë së krahut lindor të Aleancës. Pjesëmarrja e Forcës Tokësore në misionin **Forward Land Forces** është një dëshmi konkrete e besueshmërisë së Shqipërisë si vend aleat, duke kontribuar në rritjen e ndërveprueshmërisë me forcat partnere, shkëmbimin e përvojave operationale



dhe forcimin e gatishmërisë për t'iu përgjigjur sfidave të sigurisë në mjedisin euroatlantik. Forca Tokësore mbetet e përkushtuar për përmbushjen me profesionalizëm të misioneve të NATO-s, duke vijuar të japë një kontribut të çmuar në ruajtjen e paqes, stabilitetit dhe sigurisë kolektive.



Ushtarakët e Forcës Tokësore dhurojnë gjak për fëmijët talasemikë

Personeli i Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut (RKJ) dhe i Qendrës Arsimore Profesionale të Ushtarit (QAPU) iu bashkua fushatës vullnetare të dhurimit të gjakut në mbështetje të fëmijëve talasemikë, duke dhënë një kontribut të çmuar në shërbim të jetës dhe komunitetit.

Me këtë nismë humanitare, ushtarakët e Forcës Tokësore dëshmuar edhe një herë se misioni i tyre nuk kufizohet vetëm në mbrojtjen e vendit, por shtrihet edhe në mbështetjen e kauzave me rëndësi të veçantë shoqërore, duke promovuar vlerat e solidaritetit, humanizmit dhe përgjegjësisë qytetare. Dhurimi vullnetar i gjakut mbetet një akt i rëndësishëm solidariteti, i cili ndihmon drejtpërdrejt fëmijët talasemikë dhe pacientët që kanë nevojë për transfuzione të vazhdueshme, duke u dhënë atyre më shumë shpresë dhe mundësi për trajtim.

Pjesëmarrja e personelit të Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut dhe të Qendrës Arsimore Profesionale të Ushtarit në këtë fushatë pasqyron përkushtimin e vazhdueshëm të Forcës Tokësore ndaj vlerave njerëzore dhe përgjegjësisë sociale, duke treguar se shërbimi me uniformë është njëkohësisht shërbim ndaj qytetarëve dhe jetës.

Ky gjest fisnik riafirmon angazhimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për të qenë pranë komunitetit jo vetëm në përmbushjen e misioneve kushtetuese dhe operationale, por edhe në iniciativa humanitare që bëjnë ndryshim në jetën e njerëzve. Çdo dhurim gjaku është një kontribut i vyer dhe një shpresë më shumë për ata që luftojnë çdo ditë me sëmundjen.





INVESTIM NË LIDERSHIPIN USHTARAK

Diplomohen oficerët e Kursit të Lartë të Oficerit dhe Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm

Në auditorin e Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua ceremonia solemne e përfundimit të vitit akademik 2025-2026 në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, ku u diplomuan kursantët e **Kursit të Lartë të Oficerit (KLO)** dhe **Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP)**. Ceremonia shënoi përmbylljen e një viti të ngarkuar me formim profesional, studime akademike dhe përgatitje për përgjegjësi të reja drejtuese në Forcat e Armatosura.

Në këtë aktivitet morën pjesë ministri i Mbrojtjes, z. **Ermal Nufi**, zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Enkelejd Joti, zëvendësministria e Mbrojtjes znj. Pranvera Skana, ambasadori i Republikës së Kosovës në Shqipëri, z. Skënder Durmishi, Zëvendëshefja e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Razije Mehmeti, gjeneralë, komandantë të forcave, atashe ushtarakë, drejtues të institucioneve ushtarake, pedagogë, familjarë dhe të ftuar të tjerë. Atmosfera e ceremonisë pasqyroi rëndësinë që Forcat e Armatosura i kushtojnë zhvillimit të kapitalit njerëzor dhe formimit të brezit të ri të drejtuesve ushtarakë, në një kohë kur sfidat e sigurisë kërkojnë profesionalizëm, vizion strategjik dhe lidhshmëri të përgjegjshme.

Një vit përgatitje sipas standardeve të NATO-s
Kursët KLO dhe KKSHP nisën më 29 shtator 2025, në zbatim të urdhrave të Ministrit të Mbrojtjes nr. 1748 dhe nr. 1756, duke përfshirë një vit të plotë akademik me 60 kredite studimi. Programet u zhvilluan mbi bazën e standardeve të edukimit profesional ushtarak të vendeve të NATO-s dhe Bashkimit Evropian, duke kombinuar teorinë me praktikën përmes analizave strategjike, planifikimit operacional, ushtrimeve, simulimeve dhe vizitave studimore.

Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm përgatit oficerët për detyra drejtuese në nivel taktik dhe operacional, ndërsa Kursi i Lartë të Oficerit synon formimin e drejtuesve të nivelit operativ-strategjik, të aftë për të marrë vendime në mjedise komplekse kombëtare dhe ndërkombëtare.

Edhe gjatë këtij viti akademik vijoi zhvillimi i moduleve në gjuhën angleze, duke forcuar dimensionin ndërkombëtar të Kolegjit dhe përafrimin me praktikën më të mira të arsimit ushtarak euroatlantik.

83 oficerë të diplomuar, një investim për të ardhmen

Në ceremoni u diplomuan gjithsej 83 oficerë. Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm e përfunduan me sukses 64 kursantë, prej të cilëve 60 oficerë nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe 4 oficerë nga Forca e Sigurisë së Kosovës. Në këtë klasë morën pjesë 15 femra dhe 49 meshkuj.

Ndërkohë, **19 oficerë** u diplomuan në Kursin e Lartë të Oficerit, ku 16 ishin nga Forcat e Armatosura të Shqipërisë dhe 3 nga Forca e Sigurisë së Kosovës.

Prania e oficerëve nga Kosova në të dy programet vijon të dëshmojë nivelin e lartë të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të mbrojtjes të dy vendeve dhe angazhimit për zhvillimin e kapaciteteve të përbashkëta profesionale.

Ministri Nufi: Investimi te njerëzit është investimi më i rëndësishëm për mbrojtjen

Në fjalën e tij përshëndetëse, ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi, përgëzoi kursantët për përfundimin me sukses të një etape të rëndësishme të karrierës së tyre ushtarake, duke vlerësuar përkushtimin, disiplinën dhe nivelin e lartë profesional të treguar gjatë gjithë vitit akademik.

Ministri theksoi se Ministria e Mbrojtjes do të vazhdojë të qëndrojë pranë grave dhe burrave në uniformë, duke investuar në zhvillimin profesional, përmirësimin e kushteve të shërbimit dhe modernizimin e sistemit të edukimit ushtarak. Ai u shpreh se kapitali njerëzor mbetet pasuria më e



çmuar e Forcave të Armatosura dhe se investimi në përgatitjen akademike e profesionale të personelit është garancia më e mirë për përmbushjen me sukses të misionëve kombëtarë dhe angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të NATO-s.

Ministri Nufi vlerësoi veçanërisht pjesëmarrjen e oficerëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës në të dy kursët, duke theksuar se prania e **shtatë kursantëve nga Kosova** është dëshmi konkrete e marrëdhënieve të shkëlqyera ndërmjet dy vendeve.

“Shqipëria dhe Kosova ndajnë jo vetëm histori dhe vlera të përbashkëta, por edhe një vizion të njëjtë për sigurinë dhe stabilitetin rajonal. Përgatitja e përbashkët e oficerëve tanë forcon urat e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të mbrojtjes dhe krijon një bazë edhe më të fortë për sfidat e së ardhmes”, - u shpreh Ministri.

Ai nënvizoi se Ministria e Mbrojtjes do të mbështesë çdo iniciativë që rrit cilësinë e arsimit ushtarak, fuqizon bashkëpunimin ndërkombëtar dhe krijon mundësi të reja zhvillimi për personelin ushtarak.

Gjeneral brigade Altin Kurti: Udhëheqja kërkon integritet dhe vizion

Në fjalën e tij, Komandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, gjeneral brigade Altin Kurti, e cilësoi ceremoninë si një moment të rëndësishëm në jetën profesionale të çdo kursanti.

Ai theksoi se gjatë vitit akademik oficerët kanë fituar

njohuri të avancuara në planifikimin operacional, strategjinë, menaxhimin e krizave, zhvillimin e forcës dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, duke zhvilluar aftësi analitike dhe strategjike të domosdoshme për drejtuesit ushtarakë të shekullit XXI.

Gjeneral Kurti vuri në dukje se mjedisi i sigurisë po ndryshon me ritme të shpejta dhe kërkon drejtues që jo vetëm komandojnë, por frymëzojnë, krijojnë vizion, ndërtojnë besim dhe forcojnë kohezionin e organizatës.

Në përfundim, ai ftoi kursantët ta ushtrojnë lidhshmërinë me integritet, përgjegjësi dhe profesionalizëm, duke mbetur besnikë ndaj motiveve të përhershme të ushtarakut shqiptar: **“Detyra, Nderi, Atdheu”**.

Fjala e kursantëve

Në emër të të diplomuarve përshëndeti nënkolonel Valëzim Lika, i cili falënderoi stafin drejtues dhe pedagogjik për mbështetjen gjatë gjithë procesit të formimit profesional.

Ai veçoi si një nga vlerat më të rëndësishme pjesëmarrjen e oficerëve nga Kosova, duke theksuar se përvoja e përbashkët akademike forcoi shkëmbimin profesional dhe dëshmoi edhe një herë partneritetin e ngushtë ndërmjet dy forcave të armatosura.

“Nga ky Kolegj largohemi më të përgatitur profesionalisht, por edhe më të ndërgjegjshëm për përgjegjësinë që mbajmë ndaj vendit, aleancës dhe qytetarëve tanë”, - u shpreh ai.

Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë, qendra e ekselencës së edukimit ushtarak

Përmes programeve të tij, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë vijon të konsolidohet si institucioni më i lartë i edukimit profesional ushtarak në Shqipëri dhe një nga qendrat më të rëndësishme të formimit të lidhshmërit ushtarak në rajon.

Përafrimi i vazhdueshëm me standardet e NATO-s dhe Bashkimit Evropian, zgjerimi i partneriteteve ndërkombëtare, zhvillimi i moduleve në gjuhën angleze dhe përfshirja e oficerëve nga vendet partnere e bëjnë Kolegjin një institucion modern, të orientuar drejt së ardhmes.

Diplomimi i këtij viti nuk përfaqëson vetëm përfundimin e një cikli studimi, por edhe një investim afatgjatë në forcimin e kapaciteteve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe në thellimin e bashkëpunimit strategjik me Republikën e Kosovës.

Me njohuritë, përvojën dhe përgjegjësinë e fituar gjatë këtij viti akademik, oficerët e diplomuar janë tashmë të gatshëm të marrin role të reja drejtuese në repartet, shtabet dhe institucionet e mbrojtjes, duke kontribuar në garantimin e sigurisë kombëtare dhe në përmbushjen e angazhimeve të vendit në kuadër të NATO-s dhe operacioneve ndërkombëtare.



KATËR VITE NËN FLAMURIN E NATO-s

HISTORIA E SUKSESIT TË KAPITENIT TË RANGUT III, FATION CUFAJ



Intervistoi: **ANJEZA MUSOLLARI,**
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në strukturat shumëkombëshe të NATO-s, ku profesionalizmi, përgjegjësia dhe aftësia për të bashkëpunuar në një mjedis ndërkombëtar janë vlera themelore, oficerët shqiptarë vazhdojnë të dëshmojnë se janë përfaqësues të denjë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Një prej tyre është **Kapiten i Rangut III Fation Cufaj**, oficer i Forcës Detare, i cili ka përmbyllur me sukses katër vite shërbimi në një nga shtabet e NATO-s, duke lënë pas një kontribut të vlerësuar nga Aleanca dhe kolegët e tij ndërkombëtarë. Gjatë kësaj periudhe, ai ka shërbyer me profesionalizëm, integritet dhe përkushtim, duke qenë pjesë e një mjedisi operacional, ku bashkëveprimi ndërmjet vendeve aleate është çelësi i suksesit. Angazhimi i tij në shtabin shumëkombësh dhe në mbështetje të **Forcës së Reagimit të Aleatëve (Allied Reaction Force – ARF)** është një dëshmi konkrete e nivelit të përgatitjes që oficerët shqiptarë ofrojnë në strukturat e NATO-s.

Në mesazhin e përcjelljes, drejtuesit e shtabit vlerësuan profesionalizmin dhe përkushtimin e **Kapitenit të Rangut III Fation Cufaj**, duke e cilësuar atë si një shembull të qartë të kontributit të çmuar të Shqipërisë në Aleancë, në shtabin shumëkombësh dhe në misionin e Forcës së Reagimit të Aleatëve. Ky vlerësim nuk i përket vetëm një oficeri. Ai është një vlerësim për Forcën Detare, për Forcat e Armatosura Shqiptare dhe për rolin gjithnjë në rritje të Shqipërisë, si një aleate e besueshme dhe kontribuuese në arkitekturën e sigurisë kolektive. Katër vitet e shërbimit të **Kapitenit të Rangut III Fation Cufaj** janë një histori suksesi e ndërtuar mbi disiplinën, profesionalizmin dhe përkushtimin ndaj detyrës. Ato dëshmojnë se oficerët shqiptarë jo vetëm integrohen me dinjitet në strukturat më të larta të Aleancës, por edhe lënë gjurmë me punën, aftësitë dhe vlerat e tyre.

Në këtë intervistë për gazetën **“Ushtria”**, Kapiteni i Rangut të Tretë Fation Cufaj ndan përvojën e fituar gjatë shërbimit në Aleancë, sfidat e punës në një mjedis shumëkombësh, përgjegjësitë që mbart një oficer shqiptar në strukturat e NATO-s, si edhe mesazhin që dëshiron t’u përcjellë brezave të rinj të ushtarakëve që synojnë të ndjekin të njëjtën rrugë profesionale.

Kapiteni i Rangut III Cufaj, sapo keni përfunduar një mision katërvjeçar në një nga shtabet e NATO-s. Çfarë emocione ju shoqërojnë në mbyllje të kësaj eksperience?



Përfundimi i këtij misioni katërvjeçar më shoqëron me një ndjenjë të lartë krenarie, mirënjohjeje të thellë dhe përgjegjësie të shtuar për vendin tim.

Së pari, ndjej **krenari** për përfaqësimin e Forcave Detare Shqiptare në një shtab elitar ndërkombëtar siç është NRDC-

Italy (NATO Rapid Deployable Corps – Italy). Ky ka qenë një privilegj i jashtëzakonshëm për mua.

Së dyti, ndjej **mirënjohje** për rritjen profesionale. Pjesëmarrja në operacionet dhe stërvitjet e Forcës së Reagimit të Aleatëve (ARF) ka pasuruar njohuritë e mia taktike dhe strategjike. Bashkëpunimi i përditshëm me ushtarakë nga vende të ndryshme të NATO-s forcon parimin se jemi vërtet më të fortë së bashku.

Së fundmi, kjo eksperiencë sjell një **përgjegjësi të shtuar**. Me njohuritë e marra, ndihem plotësisht i gatshëm për detyrat e radhës në shërbim të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Si do ta përshkruanit me pak fjalë këtë kapitull të karrierës suaj ushtarake dhe çfarë ka përfaqësuar ai për ju si oficer i Forcës Detare Shqiptare?

Pjesëmarrja ime në NRDC-ITA ka qenë një kapitull transformues, me ritëm të lartë dhe me peshë të jashtëzakonshme për karrierën time ushtarake. Për mua, si oficer i Forcave Detare Shqiptare, kjo eksperiencë përfaqëson një fleksibilitet të lartë taktik. Shërbimi në këtë shtab të përbashkët (*joint*) provoi se jemi plotësisht të aftë të integrojmë ekspertizën detare në operacione komplekse tokësore dhe ajrore. Gjithashtu, kjo shënoi një nivel të ri profesionalizmi. Kalimi nga mjedisi operacional kombëtar në strukturat e larta të **“Allied Reaction Force”** zgjeroi vizionin tim strategjik. Përfaqësimi i vendit tim në Solbiate Olona ishte një mundësi e çmuar për të treguar se Shqipëria është një aleat i besueshëm, i përgatitur dhe me integritet të lartë ushtarak brenda NATO-s.

Cilat ishin përgjegjësitë dhe detyrat kryesore që keni mbuluar gjatë shërbimit në shtabin shumëkombësh të NATO-s?

Gjatë shërbimit katërvjeçar në shtabin e NRDC-ITA, roli im ishte në Seksionin e Inteligjencës (SO J2 Intel Section), një pozicion me rëndësi kritike për vendimmarrjen operacionale të shtabit. Detyrat e mia kryesore përfshinin:

- **Monitorimin, vlerësimin dhe analizimin** e kërcënimeve dhe të situatës operacionale në mjedisin apo rajonin e caktuar.

- **Hartimin e produkteve të inteligjencës** për të mbështetur në kohë reale operacionet e Forcës së Reagimit të Aleatëve.

- **Përgatitjen dhe skenarizimin** e elementeve të inteligjencës gjatë stërvitjeve ushtarake të NATO-s të zhvilluara nga NRDC-ITA.

Çfarë sfidash has një oficer shqiptar në një mjedis ku bashkëpunojnë ushtarakë nga dhjetëra vende aleate dhe partnere?

Puna në një mjedis shumëkombësh si NATO apo Forca e Reagimit të Aleatëve (ARF) i përball oficerët shqiptarë me sfida komplekse operacionale, kulturore dhe logjistike. Përballimi i tyre kërkon përshtatshmëri të lartë dhe fleksibilitet. Sfidat kryesore janë:

- **Barriera gjuhësore dhe komunikimi taktik:** Edhe pse anglishtja dhe frëngjishtja janë gjuhët zyrtare, përdorimi i terminologjisë specifike ushtarake, akronimeve të NATO-s dhe thekseve të ndryshme kombëtare mund të krijojë vështirësi në situata specifike.

- **Ndërveprueshmëria teknologjike dhe doktrinare (Interoperability):** Koordinimi i sistemeve të ndryshme të komunikimit, armatimit dhe logjistikës ndërmjet vendeve aleate kërkon një përpjekje të vazhdueshme për të harmonizuar procedurat sipas standardeve STANAG.

- **Dallimet në kulturën ushtarake:** Çdo ushtri ka kulturën e saj të lidhshme, delegimit të detyrave dhe marrjes së vendimeve. Përshtatja me hierarkitë ose stilet e menaxhimit të vendeve të tjera kërkon diplomaci ushtarake.

- **Menaxhimi i perceptimeve gjeopolitike:** Përfaqësimi i interesave dhe qëndrimeve të një vendi të Ballkanit në tryezat ku diskutohen strategji globale kërkon një njohje të thellë të politikës së jashtme dhe të sigurisë.

Si u prit kontributi i oficerëve shqiptarë nga kolegët dhe drejtuesit e Aleancës? A ndjetë se Shqipëria gëzon respekt dhe besueshmëri brenda NATO-s?

Kontributi i oficerëve shqiptarë vlerësohet lart nga kolegët dhe drejtuesit e Aleancës, duke konfirmuar se Shqipëria gëzon respekt dhe besueshmëri të plotë brenda NATO-s. Profesionalizmi dhe disiplina e dëshmuar e oficerëve tanë vlerësohen për etikën e lartë të punës, aftësinë për t’u përshtatur shpejt në shtabe shumëkombëshe, si dhe për gatishmërinë për të marrë përsipër detyra me përgjegjësi të lartë.

Në mesazhin e përcjelljes u vlerësuar për profesionalizmin dhe përkushtimin tuaj. Çfarë do të thotë për ju ky vlerësim nga drejtuesit e NATO-s?

Ky vlerësim nga drejtuesit e NRDC-ITA (NATO Rapid Deployable Corps – Italy) është një privilegj shumë i madh për





mua, që konfirmon dhe një herë se ne ushtarakët shqiptarë trajtohem i të barabartë dhe me respekt të plotë në strukturat më të larta të sigurisë globale. Ky vlerësim bazohet te **saktësia taktike dhe shpejtësia** në përpunimin e të dhënave, të cilat i përgjigjën me sukses kërkesave kritike të komandës si dhe **përkushtimi institucional** ndaj misionit, duke kontribuar drejtpërdrejt në ruajtjen e gatishmërisë së lartë operacionale që karakterizon NRDC-ITA.

Gjatë këtyre katër viteve, cili ka qenë momenti që do ta konsideronit më domethënës ose më sfidues në detyrën tuaj?

Momenti më domethënës dhe njëkohësisht më sfidues ka qenë procesi i tranzicionit dhe marrja e komandës së Forcës së Reagimit të Aleatëve (*Allied Reaction Force – ARF*) të NATO-s, i cili kulmoi me certifikimin dhe fillimin zyrtar të misionit në korrik të vitit 2024. Ky proces mbart një kompleksitet të lartë për shkak të:

Sfidave të integritimit shumëkombësh: Koordinimi i forcave tokësore, detare, ajrore e kibernetike nga vende të ndryshme aleate kërkon një shkallë të lartë ndërveprueshmërie taktike dhe teknike;



Stërvitjeve të përbashkëta (Joint): Përgatitjet intensive përmes stërvitjeve si “*Steadfast Deterrence*” dhe “*Steadfast Dart*” ku testuan në limite zinxhirin e vendimmarrjes dhe gatishmërinë operacionale;

Adoptimit të teknologjive të reja: Integrimi i sistemeve të avancuara të Komandim-Kontrollit (C2) dhe platformave të Inteligjencës Artificiale (si *Project Maven*) rriti shpejtësinë e analizës së të dhënave, por solli edhe një kurbë të fortë mësimi. Ky transformim e ktheu komandën e NRDC-ITA, nga një seli taktike në një shtyllë kryesore të mbrojtjes kolektive të NATO-s.

Si ka ndikuar kjo përvojë në zhvillimin tuaj profesional dhe si mendoni se do ta pasurojë shërbimin tuaj në Forcat e Armatosura pas rikthimit në Shqipëri?

Shërbimi për katër vite në Degën J2 (Intelligence/Zbulimi) të NRDC-ITA ka konsoliduar profilin tim profesional në nivel të lartë ushtarak. Pas rikthimit në Shqipëri, këto njohuri do të shërbejnë për Implementimin e metodologjive më bashkëkohore të analizës taktike dhe strategjike, të përfutuara nga zotërimi i standardeve të Ciklit të Inteligjencës (*Intelligence Cycle*) në mjedise të përbashkëta. Përdorimin e kësaj përvoje si urë lidhëse për të përafruar procedurat tona kombëtare me ato të Aleancës, veçanërisht në shkëmbimin e sigurt të informacionit si dhe informimin e personelit mbi trendet e reja të inteligjencës ushtarake, përfshirë mjetet digjitale, sistemet e avancuara (si *Project Maven*) dhe menaxhimin e fluksit të madh të të dhënave (Big Data/OSINT).

Forca e Reagimit të Aleatëve (ARF) është një komponent kyç i NATO-s. Çfarë mund të na thoni për rëndësinë e saj dhe për rolin që keni pasur në mbështetje të këtij formacioni?

Forca e Reagimit të Aleatëve (ARF) përfaqëson shtyllën kryesore të mbrojtjes kolektive të NATO-s, e projektuar si një forcë strategjike me gatishmëri jashtëzakonisht të lartë për aktivizim të menjëhershëm në rast krizash. Rëndësia e saj strategjike bazohet në tre elemente:

Gatishmëri e menjëhershme: Zëvendësimi i Forcës së Reagimit të NATO-s (NRF) me qëllim dislokimin e trupave brenda pak ditësh;

Mbrojtje multidomenale: Integrimi i plotë i operacioneve tokësore, ajrore, detare, kibernetike dhe atyre të hapësirës;

Parandalim i konflikteve: Funksionimi si një rezervë strategjike e aftë për të parandaluar përshkallëzimin e krizave në kufijtë e Aleancës. Roli im në Degën J2 ka qenë mbështetja e pandërprerë me informacione dhe analiza të zbulimit për të garantuar vendimmarrjen e këtij formacioni.

Sa e rëndësishme është për një oficer shqiptar të punojë në një mjedis shumëkombësh dhe çfarë përfiton ai nga ky bashkëpunim?

Pjesëmarrja në një mjedis shumëkombësh si NATO ose ARF është

shumë e rëndësishme për zhvillimin profesional të një oficeri shqiptar, pasi rrit drejtpërdrejt aftësitë e tij operacionale në Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH). Përfitimet kryesore përfshijnë:

- **Ndërveprueshmëri e plotë (Interoperability):** Unifikimi i doktrinave, taktikave dhe procedurave të komunikimit me aleatët sipas standardeve STANAG.

- **Qasje në teknologji dhe inteligjencë:** Përdorimi i sistemeve të avancuara të mbrojtjes, komandimit, kontrollit dhe shkëmbimit të informacionit që tejkalojnë nivelin kombëtar.

- **Zhvillim i lidërshit strategjik:** Formësimi i aftësisë për të udhëhequr trupa shumëkombëshe dhe për të menaxhuar kriza reale.

- **Rritje e kredibilitetit profesional:** Përfaqësimi dinjitoz që rrit autoritetin e oficerit dhe besueshmërinë e Shqipërisë brenda strukturave të Aleancës.

Përtej aspektit profesional, çfarë ju ka lënë kjo eksperiencë në planin njerëzor? A ka ndonjë mësim apo kujtim që do ta mbani gjithmonë me vete?

Përtej uniformës dhe gradave ushtarake, këto katër vite në NRDC-ITA kanë qenë një shkollë e jashtëzakonshme njerëzore. Bashkëpunimi i përditshëm me kolegë të kombeve të ndryshme dëshmon se diversiteti kulturor përbën një pasuri të madhe. Mësimi më i çmuar njerëzor që marr me vete është se besimi i vërtetë ndërtohet në grup. Gjatë operacioneve dhe stërvitjeve intensive, dallimet kombëtare u zbehën për t’ia lënë vendin një fryme vëllazërie dhe solidariteti të pastër. Ndjenja e të qenit i respektuar si i barabartë mes të barabartëve në tryezat e komandës së NATO-s është një eksperiencë me vlerë të lartë personale. Ndërveprimi kulturor, mikpritja në Itali dhe miqësitë e qëndrueshme të krijuara me kolegë nga mbarë bota janë kujtime që do t’i ruaj gjatë gjithë jetës.

Si e shihni sot nivelin e përgatitjes së Forcave të Armatosura Shqiptare në raport me standardet e Aleancës?

Sot, niveli i përgatitjes së Forcave të Armatosura Shqiptare dëshmon se Shqipëria është një kontribuuese e besueshme dhe e integruar plotësisht në strukturat e NATO-s. Përparimi i FA-së në raport me standardet e Aleancës mund të them që konsolidohet në disa pika kyçe:

Ndërveprueshmëri e lartë operacionale: Pjesëmarrja e suksesshme e trupave tona në misione ndërkombëtare dhe integrimi i oficerëve shqiptarë në komanda elitare si NRDC-ITA vërteton se ne ndajmë të njëjtën gjuhë ushtarake, taktike dhe doktrinale me aleatët.

Modernizimi i kapaciteteve: Investimet strategjike në sisteme të avancuara, si helikopterët “*Black Hawk*”, dronët “*Bayraktar*”, si dhe në sisteme moderne të komunikimit dhe mbrojtjes kibernetike, po përafrojnë infrastrukturën tonë me standardet teknologjike të NATO-s.

Integrimi i plotë mbetet një proces dinamik. Sfidat kryesore konsistojnë në përthithjen e shpejtë të teknologjive të reja dhe trajnimin e vazhdueshëm të personelit për t’u përballur me luftën moderne, fushë ku përvoja e fituar në strukturën J2 të NRDC-ITA mbart një vlerë të jashtëzakonshme

Çfarë mesazhi do t’u përcillnit oficerëve dhe nënoficerëve të rinj që synojnë të shërbejnë në strukturat e NATO-s?

Mesazhi im për çdo oficer dhe nënoficer të ri që synon të shërbejë në strukturat e NATO-s është që ta konsiderojnë veten profesionalisht si pjesëtarë me vlerë të barabartë në një aleancë të madhe globale. Për të pasur sukses në këtë mjedis elitare, sugjeroj:

Investim të vazhdueshëm në njohuri: Standardet e NATO-s përditësohen me shpejtësi dhe është e domosdoshme njohja e doktrinave, zotërimi i gjuhëve të huaja operative dhe kuptimi i procedurave të përbashkëta (*Joint Operations*).

Përqafimi e teknologjive të reja: Fushat si inteligjenca artificiale, operacionet kibernetike dhe analiza e të dhënave (Big Data) përfaqësojnë të ardhmen e luftës moderne.

Integriteti dhe karakteri: Në strukturat ndërkombëtare, besueshmëria fitohet përmes përkushtimit dhe çdo detyrë duhet të përmbushet me standardin më të lartë.

Ruajtja e krenarisë kombëtare: Përfaqësimi i flamurit Shqiptar në tryezat shumëkombëshe mbart përgjegjësinë që performanca juaj të jetë një gur themeli dhe të hapë dyer për brezat pasardhës.

Pas përfundimit të këtij misioni, cilat janë objektivat dhe sfidat tuaja të ardhshme profesionale?

Pas përfundimit të misionit në NRDC-ITA dhe rikthimit tim në Forcën Detare, objektivat dhe sfidat e mia janë të lidhura me integrimin e eksperiencës së fituar në NRDC-ITALI në Forcat tona Detare. Zbatimin e procedurave të NATO-s për mbledhjen dhe analizën e informacionit operativ, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi situatën detare (*Maritime Domain Awareness*). **Rritjen e ndërveprueshmërisë në det:** Përafrimin e procedurave tona të komunikimit dhe veprimit me ato të grupeve të përhershme detare të NATO-s (SNMG/SNMCWG).

Monitorimin e kërcënimeve asimetrike: Përballjen me sfidat e sigurisë hibride në detet Adriatik dhe Jon, si trafiku i paligjshëm dhe siguria e infrastrukturës kritike nënujore.

Nëse do ta përmbledhnit këtë eksperiencë me një fjalë, cila do të ishte ajo?

Kjo eksperiencë katërvjeçare në J2 NRDC-ITA ishte për mua një rrugëtim elitare që konsolidoi profesionalizmin tim sipas standardeve të NATO-s, duke më përgatitur në aspektin njerëzor dhe ushtarak për t’i shërbyer me dinjitet Forcës sonë Detare në një plan strategjik afatgjatë.

NJË SHEKULL NË SHËRBBIM TË JETËS, KOMBIT DHE USHTARIT SHQIPTAR

102 vjet Shërbimi i Shëndetësisë Shqiptare – Historia e një misioni që nuk ka njohur kurrë pushim

Ka institucione që ndërtojnë shtetin me ligje. Ka të tjera që e mbrojnë me armë. Por ka edhe institucione që e mbajnë në këmbë duke mbrojtur jetën. Pikërisht kësaj kategorie i përket Shërbimi i Shëndetësisë Shqiptare, një nga shtyllat më të rëndësishme të shtetit modern shqiptar, i cili këtë vit shënon një shekull nga krijimi i tij.

Më 16 korrik 1924, Shqipëria hodhi një hap vendimtar në organizimin e jetës shtetërore. Ishte një vend i ri, me institucione ende të brishta, me pak mjekë, me mungesë infrastrukture dhe me sfida të shumta shëndetësore. Epidemitë, kushtet e vështira të jetesës dhe mungesa e shërbimeve bazë e bënë mbrojtjen e shëndetit një domosdoshmëri kombëtare. Pikërisht në këtë realitet lindi Shërbimi i Shëndetësisë Shqiptare, jo si një strukturë administrative, por si një mision për të mbrojtur jetën.

Një shekull më vonë, historia dëshmon se ky ishte një nga vendimet më të mençura të shtetit shqiptar.

Nëse ushtria është garancia e sovranitetit, atëherë shërbimi shëndetësor është garancia e forcës së saj. Asnjë ushtri nuk mund të jetë e gatshme pa mjekët, infermierët, farmacistët, laborantët dhe specialistët që kujdesen për shëndetin e efektivëve të saj. Për këtë arsye, zhvillimi i Shërbimit Shëndetësor ka ecur paralelisht me zhvillimin e vetë Forcave të Armatosura.

Në vitet e para të shtetit shqiptar, çdo hap përpara ishte një fitore. U krijuan njësitë e para sanitare, u organizuan shërbimet mjekësore pranë reparteve dhe u hodhën themelet e mjekësisë ushtarake shqiptare. Mjekët e parë ushtarakë, shumë prej të cilëve kishin studiuar në universitetet më të mira të Evropës, sollën në Shqipëri jo vetëm dije profesionale, por edhe një kulturë të re shërbimi.

Ata kuptuan se mbrojtja e ushtarit nuk fillon vetëm në fushën e betejës. Ajo fillon shumë më herët, në kontrollin mjekësor, në parandalimin e sëmundjeve, në edukimin shëndetësor dhe në krijimin e kushteve që çdo ushtar të jetë fizikisht dhe mendërisht i gatshëm për detyrën.

Ky ishte një vizion modern për kohën.

Historia e Shëndetësisë Shqiptare është një histori sakrifice të heshtur. Mjekët nuk kanë qenë gjithmonë në qendër të vëmendjes. Ata nuk kanë parakaluar në ceremoni ushtarake me armë në dorë dhe as janë përmendur shpesh në librat e historisë ushtarake. Megjithatë, kontributi i tyre ka qenë vendimtar. Ata kanë qenë aty në çdo kohë. Në repartet ushtarake. Në spitalet ushtarake.

Në fatkeqësitë natyrore. Në operacionet e kërkim-shpëtimit. Në misionet paqeruajtëse jashtë vendit. Aty ku ushtari ka pasur nevojë për ndihmë, aty ka qenë edhe mjeku ushtarak.

Kur humanizmi veshi uniformën

Pas Luftës së Dytë Botërore, sistemi shëndetësor mori një zhvillim më të gjerë. U ndërtuan spitale, u zgjeruan kapacitetet diagnostikuese, u formuan breza të rinj mjekësh dhe u ngritën struktura të specializuara që do të mbështesnin jo vetëm ushtrinë, por edhe popullsinë civile në situata emergjente. Shërbimi Shëndetësor u bë pjesë e sigurisë kombëtare. Në dekadat që pasuan, mjekët ushtarakë u përgatitën për të përballuar çdo skenar, nga emergjencat civile deri te situatat e jashtëzakonshme. Ata punuan në kushte të vështira, shpesh larg familjeve, me një përgjegjësi të jashtëzakonshme mbi supë: të shpëtimit jetën. Ky është profesioni i tyre. Por mbi të gjitha, ky është betimi i tyre.

Një shekull me misionin më fisnik: të shpëtosh jetën

Pas viteve '90, Shqipëria ndryshoi. Ndryshoi edhe



ushtria. Ndryshoi edhe mënyra se si konceptohej mbështetja shëndetësore.

Anëtarësimi në NATO solli standarde të reja, teknologji të reja dhe një filozofi të re të mjekësisë ushtarake. Sot, personeli shëndetësor i Forcave të Armatosura është pjesë e misioneve ndërkombëtare, stërvitjeve shumëkombëshe dhe operacioneve humanitare. Mjekët shqiptarë punojnë krah për krah me kolegët e vendeve aleate, duke dëshmuar profesionalizëm dhe aftësi që vlerësohen në çdo mision.

Por, pavarësisht teknologjisë dhe modernizimit, një gjë nuk ka ndryshuar.

Misioni.

Ai mbetet i njëjtë si njëqind vjet më parë.

Të mbrosh jetën.

Të mbrosh ushtarin.

Të mbrosh njeriun.

Kjo është arsyeja pse për më shumë se 100 vjet nuk është vetëm një festë institucionale. Është një moment për të nderuar të gjithë ata që kanë shkruar këtë histori me punë, dije dhe sakrificë.

Historia e një misioni që nuk njeh pushim

Është dita për të kujtuar brezat e mjekëve që punuan kur mungonin pajisjet, kur rrugët ishin të pakalueshme dhe kur çdo ndërhyrje kërkonte guxim përtej profesionit.

Është dita për të falënderuar infermierët që kanë kaluar net të tëra pranë pacientëve. Është dita për të respektuar farmacistët, laborantët, teknikët, sanitarët dhe çdo punonjës që ka qenë pjesë e kësaj historie. Sepse institucionet nuk ndërtohen vetëm me godina. Ato ndërtohen me njerëz. Me

njerëz që besojnë te misioni i tyre.

Shërbimi i Shëndetësisë Shqiptare është sot një institucion modern, me kapacitete profesionale, me personel të kualifikuar dhe me standarde që i përgjigjen kërkesave të një ushtrie të integruar në NATO. Por forca e tij më e madhe nuk qëndron vetëm te pajisjet moderne apo infrastruktura.

Forca e tij qëndron te njerëzit. Te mjekët që zgjedhin të veshin uniformën. Te infermierët që nuk njohin orar kur jeta është në rrezik. Te specialistët që e konsiderojnë çdo ushtar si përgjegjësi personale.

Në një botë ku siguria nuk matet vetëm me armë, por edhe me aftësinë për të mbrojtur jetën, Shërbimi i Shëndetësisë Shqiptare mbetet një nga garancitë më të forta të gatishmërisë së Forcave të Armatosura. Një shekull histori nuk është vetëm një përvjetor. Është një trashëgimi. Është një amanet. Është një përgjegjësi për brezat që do të vijnë.

Gazeta “Ushtria” përkulet me respekt para të gjithë mjekëve, infermierëve, farmacistëve, laborantëve, oficerëve dhe nënoficerëve të shëndetësisë ushtarake që, gjatë këtyre njëqind viteve, kanë dëshmuar se shërbimi ndaj jetës është forma më fisnike e shërbimit ndaj atdheut. Sepse një ushtri e fortë ndërtohet me armë moderne, me stërvitje të vazhdueshme dhe me disiplinë.

Por ajo mbetet e fortë vetëm atëherë kur di të mbrojë jetën e njerëzve të saj.

Ky është misioni që Shërbimi i Shëndetësisë Shqiptare e ka përmbushur për një shekull.

Dhe ky është misioni që do ta udhëheqë edhe në shekullin e dytë të historisë së tij.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Ka fjali që nuk janë thjesht rrëqethëse. Janë një aktakuzë ndaj ndërgjegjes sonë kolektive: “Gruan time vrava.”

Vetëm tri fjalë. Tri fjalë që mbajnë brenda një jetë të marrë padrejtësisht, një familje të shkatërruar, fëmijë të mbetur pa nënë, prindër të zhytur në dhimbje dhe një shoqëri që edhe një herë zgjohet e tronditur, vetëm për t’u mësuar pak ditë më vonë me tragjedinë e radhës.

Ngjarja e rëndë në Shkodër nuk është vetëm një kronikë e zezë. Nuk është një lajm që zë faqet e portaleve për disa orë. Është një kabanë alarmi që bie prej shumë vitesh dhe që vazhdon të mos dëgjohet sa duhet.

Në Shqipëri vazhdojmë të numërojmë gra të vrara nga njerëzit që dikur u premtuan dashuri, mbrojtje dhe një jetë të përbashkët. Ironia më e hidhur është se vendi që duhet të ishte më i sigurt, shtëpia për shumë gra është kthyer në vendin më të rrezikshëm.

Fjala “ime” në shprehjen “gruan time vrava” është ndoshta pjesa më tronditëse.

Ajo nuk shpreh dashuri. Nuk shpreh lidhje. Nuk shpreh familje.

Shpreh pronësi.

Një mendësi që ende mbijeton në shumë cepa të shoqërisë sonë, ku gruaja shihet si diçka që i përket burrit, ku xhelozia justifikohet si dashuri, kontrolli quhet kujdes, dhuna quhet “konflikt familjar”, ndërsa kërcënimet shpesh minimizohen deri sa bëhen plumba, thika ose duar që marrin jetë.

Askush nuk lind vrasës.

Por një shoqëri që hesht përballë dhunës, që relativizon fyerjet, që fal goditjen e parë, që i thotë gruas “duro për hir të fëmijëve”, krijon terrenin ku tragjeditë bëhen të mundshme.

Çdo femicid ka pas vetes dhjetëra sinjale që nuk u morën seriozisht.

Është e lehtë të indinjohemi për një ditë.

Është më e vështirë të ndryshojmë mënyrën si edukojmë djemtë tanë. Që në fëmijëri duhet t’u mësojmë se respekti nuk fitohet me forcë. Se burrëria nuk matet me dominim. Se një “jo” është “jo”. Se partnerja nuk është pronë, por një njeri me të njëjtën dinjitet dhe të njëjtat të drejta.

Po aq e rëndësishme është të edukojmë vajzat që të mos e pranojnë dhunën si fat, të mos e quajnë sakrificë atë që në të vërtetë është nënshtrim dhe të kërkojnë ndihmë që në shenjat e para të rrezikut.

Institucionet kanë përgjegjësinë e tyre

Policia. Prokuroria. Gjykatat. Shërbimet sociale. Psikologët. Shkollat. Por edhe ne kemi përgjegjësinë tonë si qytetarë. Sa herë kemi dëgjuar britma nga banesa ngjitur dhe kemi menduar: “Nuk është puna ime”?


Sa herë kemi parë një grua të frikësuar dhe kemi zgjedhur të mos pyesim?

Sa herë kemi justifikuar dhunuesin me fjalinë e zakonshme: “I iku mendja”? Jo. Nuk është çështje humori. Nuk është nervozizëm.

Nuk është “problem familjar”. Është krim.

Shpesh pas çdo ngjarjeje dëgjojmë të njëjtën fjali: “Askush nuk e priste.” Por zakonisht dikush e kishte parë frikën. Dikush kishte dëgjuar kërcënimet. Dikush kishte vënë re

“Gruan time vrava”: Kur fjala humbet çdo kuptim njerëzor



izolimin. Dikush kishte kuptuar se diçka nuk shkonte. Dhe megjithatë, heshtja fitoi. Nuk mund të vazhdojmë të jetojmë në një shoqëri ku gratë duhet të provojnë se janë në rrezik vetëm pasi të jenë vrarë.

Një grua nuk humbet jetën vetëm nga dora e vrasësit. Ajo humbet edhe nga indiferenca. Nga stereotipat. Nga mungesa e mbështetjes. Nga mosbesimi. Nga paragjykimi. Nga fjalia cinike: “Çfarë kishte bërë që e vrau?”

Pyetja e vetme që duhet bërë është: Çfarë nuk bëri shoqëria jonë që kjo jetë të shpëtohej?

Sepse çdo grua e vrarë është një dështim kolektiv. Është dështim i institucioneve kur nuk mbrojnë. Është dështim i komunitetit kur hesht. Është dështim i familjes kur justifikon.

Është dështim i edukimit kur rrit burra që ngatërrojnë dashurinë me pushtetin.

“Gruan time vrava.”

Kjo fjali nuk duhet të mbetet vetëm një titull kronike. Duhet të mbetet një kujtesë e dhimbshme se sa larg jemi ende nga një shoqëri ku jeta e një gruaje është e paprekshme. Asnjë grua nuk është pronë. Asnjë burrë nuk ka të drejtë mbi jetën e saj. Dhe asnjë shoqëri nuk mund të quhet e qytetëruar, nëse vazhdon të numërojë gratë e vrara vetëm pasi është derdhur gjaku.

Sepse një grua nuk duhet të mbrohet vetëm pasi të jetë bërë lajm.

Ajo duhet të mbrohet sa është ende gjallë.

FLAMURI KUQEZI PARAKALON NË CHAMPS-ÉLYSÉES

Forcat e Armatosura shqiptare në paradën e 14 Korrikut, simbol i partneritetit strategjik me Francën dhe i dinjitetit të aleancës euroatlantike

Forcat e Armatosura shqiptare në paradën madhështore të 14 Korrikut, simbol i aleancës, besimit dhe dinjitetit ushtarak

Ka ngjarje që tejkalojnë ceremonialin dhe shndërrohen në mesazhe të forta politike, historike dhe ushtarake. Parada e 14 Korrikut në Paris është një prej tyre. Çdo vit, bulevardi **legjendar Champs-Élysées** shndërrohet në skenën ku Franca nderon historinë e saj, vlerat republikane, sakrificat e brezave dhe forcën e institucioneve që garantojnë lirinë dhe sigurinë e vendit.

Edhe këtë vit, në Ditën Kombëtare të Francës, mijëra qytetarë dhe qindra mijëra shikues nga e gjithë bota ndoqën paradën ushtarake, një nga ceremonitë më prestigjioze në Evropë dhe në botë. Përgjatë bulevardit simbol të Parisit parakaluan formacione të Forcave të Armatosura franceze, mjete ushtarake moderne, aviacioni luftarak dhe delegacione ushtarake nga vendet aleate, duke dëshmuar jo vetëm fuqinë mbrojtëse të Francës, por edhe unitetin e aleatëve që ndajnë të njëjtat vlera të lirisë, demokracisë dhe sigurisë kolektive.

Mes flamujve të kombeve pjesëmarrëse u valëvit me krenari edhe flamuri kuqezi. Ishte një moment me domethënie të veçantë për Shqipërinë dhe Forcat e saj të Armatosura. Në zemër të Parisit, aty ku historia takohet me të ardhmen, prania e ushtarakëve shqiptarë ishte më shumë se një pjesëmarrje ceremoniale. Ajo ishte dëshmi e rolit që Shqipëria ka fituar në arkitekturën e sigurisë euroatlantike dhe e besimit që aleatët kanë ndaj profesionalizmit të ushtarakëve shqiptarë.

Për një ushtarak shqiptar, të marshosh në Champs-Élysées nuk është vetëm një nder personal. Është privilegji për të përfaqësuar flamurin kombëtar përkrah ushtrive më të fuqishme të botës. Është përgjegjësi për të treguar se Shqipëria është një aleate e besueshme, e gatshme të kontribuojë në misionet e NATO-s dhe në ruajtjen e paqes ndërkombëtare.

Pjesëmarrja e Forcave të Armatosura shqiptare në këtë paradë pasqyron rrugëtimin që ushtria jonë ka bërë gjatë dekadave të fundit. Nga një forcë në proces transformimi, ajo është shndërruar në një institucion modern, të interoperueshëm me ushtritë aleate, me standarde të larta profesionale dhe me një kontribut të vlerësuar në operacionet ndërkombëtare. Në Afganistan, Kosovë, Bosnjë e Hercegovinë, Letoni, Bullgari dhe në misione të tjera të NATO-s dhe Bashkimit Evropian, ushtarakët shqiptarë kanë dëshmuar disiplinë, profesionalizëm dhe përkushtim.

Prania e flamurit shqiptar në paradën e Ditës Kombëtare të Francës ishte gjithashtu një simbol i marrëdhënieve të forta mes dy vendeve. Shqipëria dhe Franca janë të lidhura nga një partneritet që mbështetet në vlera të përbashkëta demokratike, në bashkëpunimin brenda NATO-s dhe në angazhimin për sigurinë e kontinentit evropian. Në një kohë kur sfidat ndaj sigurisë janë bërë më komplekse se kurrë, solidariteti mes aleatëve mbetet garancia më e fortë për stabilitetin dhe paqen.



Parada e 14 Korrikut është shumë më tepër se një demonstrim i kapaciteteve ushtarake. Ajo është një homazh për gratë dhe burrat me uniformë, për ata që zgjedhin t'i shërbejnë atdheut me disiplinë,



sakrificë dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie. Çdo hap i sinkronizuar në Champs-Élysées përcjell një mesazh të qartë: siguria nuk është rastësi, ajo ndërtohet çdo ditë nga njerëz që janë të gatshëm të vendosin detyrën mbi interesin personal.

Për Shqipërinë, pjesëmarrja në këtë ceremoni është një moment krenarie kombëtare. Ajo dëshmon se vendi ynë nuk është thjesht përfitues i sigurisë kolektive, por një kontribuues aktiv në të. Është një dëshmi se Forcat e Armatosura shqiptare kanë fituar respektin e partnerëve strategjikë përmes punës, profesionalizmit dhe përkushtimit të tyre.

Kur flamuri kuqezi valëvitej përgjatë Champs-Élysées, ai nuk përfaqësonte vetëm një shtet. Ai përfaqësonte historinë e një kombi që ka zgjedhur të jetë pjesë e familjes euroatlantike, sakrificën e brezave të ushtarakëve shqiptarë dhe aspiratën për të qenë gjithmonë në krah të aleatëve në mbrojtje të paqes dhe sigurisë.

Në fund të paradës, mbeti një imazh që flet më shumë se çdo fjalë: flamuri shqiptar, i ngritur me dinjitet mes flamujve të vendeve aleate, në bulevardin më të njohur të Francës. Një simbol krenarie për çdo shqiptar dhe një dëshmi se Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë sot pjesë e pandashme e arkitekturës së sigurisë euroatlantike.

Sepse në botën e sotme, forca e një ushtrie nuk matet vetëm me armatimin që zotëron, por edhe me besimin që frymëzon te aleatët dhe me flamurin që mban me nder në çdo mision, në çdo ceremoni dhe në çdo sfidë ku kërkohet të mbrohen liria, paqja dhe vlerat demokratike.

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefë e Sektorit të Botimeve

Më shumë se bashkëshorte,
gratë që ndërtojnë ura besimi

Në çdo Samit të NATO-s, kamerat ndjekin presidentët, kryeministrat, ministrat e mbrojtjes dhe komandantët ushtarakë. Objektivat fokusohen te vendimet për sigurinë, mbrojtjen kolektive, konfliktet dhe paqen. Në sallat ku merren vendime që ndikojnë fatin e miliona njerëzve, protagonizmi u takon liderëve. Por, jashtë tryezave të negociatave, ekziston një dimension tjetër i samitit. Një dimension më i qetë, më pak i zhurmshëm, por jo më pak domethënës.

Janë gratë. Bashkëshortet e presidentëve, kryeministrave dhe liderëve të vendeve aleate. Ato nuk firmosin marrëveshje. Nuk mbajnë konferenca shtypi. Nuk votojnë rezoluta. Megjithatë, prania e tyre nuk është kurrë protokollare. Historia ka treguar se pranë çdo burri që ka mbajtur mbi supe peshën e drejtimit të një kombi, ka qëndruar një grua që ka ndikuar në mënyrën si ai mendon, si vendos, si përballon barrën e pushtetit dhe, mbi të gjitha, si mbetet njeri.

Pushteti është i ftohtë

Ai kërkon vendime të vështira, sakrifica, orë të gjata pune dhe përgjegjësi që shpesh nuk ndahen me askënd. Në fund të ditës, edhe presidenti më i fuqishëm i botës mbetet bashkëshort, baba, njeri. Dhe pikërisht aty fillon ndikimi i gruas.

Jo në sallën e negociatave. Por në jetën. Në qetësinë e shtëpisë. Në këshillën që nuk dëgjohet nga mikrofonat. Në mbështetjen që nuk fotografohet. Në forcën morale që nuk shkruhet në procesverbal.

Përtej imazhit

Fotografitë e grave në Samitin e NATO-s nuk tregojnë vetëm elegancë.

Ato tregojnë personalitete.

Gra të arsimuara.

Profesioniste.

Diplomate.

Shkencëtare.

Juriste.

Mjeke.

Aktiviste.

Gra që kanë ndërtuar identitetin e tyre shumë përpara se të bëheshin bashkëshortet e liderëve të shteteve. Kjo është arsyeja pse roli i tyre nuk mund të reduktohet në protokoll. Në diplomacinë moderne ekziston një koncept gjithnjë e më i rëndësishëm: **diplomacia e butë**.

Ajo nuk zhvillohet vetëm në tryezat zyrtare. Ajo ndërtohet edhe përmes kulturës, komunikimit, humanizmit dhe marrëdhënieve njerëzore. Pikërisht këtu gratë kanë një rol të pazëvendësueshëm. Një vizitë në një qendër sociale. Një takim me fëmijë. Një aktivitet kulturor. Një mesazh solidariteti. Shpesh ndikojnë në perceptimin e një vendi më shumë sesa një deklaratë politike.

Nuk është rastësi që gjatë samiteve ndërkombëtare organizohen programe të veçanta për bashkëshortet e liderëve. Ato nuk janë thjesht shoqëruese.

Janë ambasadore të kulturës, të dialogut dhe të vlerave që përfaqësojnë vendet e tyre.

Në çdo buzëqeshje, në çdo takim, në çdo gjest njerëzor, ndërtohen ura besimi mes kombeve.

Në një botë ku luftërat vazhdojnë të marrin jetë, ku tensionet ndërkombëtare mbeten të larta dhe ku siguria globale sfidohet çdo ditë, këto ura kanë një vlerë të jashtëzakonshme. Sepse paqja nuk ndërtohet vetëm me armë. Ajo ndërtohet me besim. Me mirëkuptim. Me dialog. Dhe gratë kanë dëshmuar se janë mjeshtrë të këtij komunikimi.

Shpesh themi se pas çdo burri të suksesshëm qëndron një grua e fortë.

Ndoshta koha kërkon ta ndryshojmë këtë shprehje. Jo pas. Pranë. Sepse partneriteti nuk ka hierarki. Ai është bashkëudhëtim.



FUQIA E GRAVE
QË FRYMËZON
LIDERËT E BOTËS

Presidentët dhe kryeministrat mbajnë mbi supe përgjegjësinë për vendimet historike. Por askush nuk mund ta mbajë vetëm barrën e historisë. Pranë tyre qëndrojnë njerëzit më të afërt. Ata që njohin anën njerëzore të liderit. Ata që nuk shohin postin, por njeriun. Shpesh janë pikërisht këta njerëz që e ndihmojnë të ruajë ekuilibrin, maturinë dhe ndjeshmërinë.

Në Shqipëri kemi parë gjithnjë e më shumë gra që nuk kufizohen nga roli ceremonial. Ato angazhohen në projekte sociale, në mbështetje të fëmijëve, grave, arsimit, kulturës dhe shëndetësisë. Ky është modeli që kërkon koha.

Një grua që nuk jeton në hijen e bashkëshortit. Por ecën pranë tij. Me personalitetin e saj. Me dinjitetin e saj. Me kontributin e saj.

Fotografitë e Samitit të NATO-s nuk janë vetëm kujtime protokollare. Ato janë një dëshmi se në qendër të politikës ndërkombëtare vazhdon të qëndrojë njeriu.

Dhe aty ku është njeriu, është edhe gruaja.

Jo si dekor.

Jo si figurë dytësore.

Por si zë i maturisë.

Si simbol i qytetërimit.

Si forcë që bashkon.

Gratë që i japin fytyrë diplomacisë

Në një kohë kur bota përballlet me luftëra, kriza dhe pasiguri, ndoshta kemi nevojë më shumë se kurrë për këtë fuqi të qetë.

Për forcën që nuk imponon.

Për ndikimin që nuk kërkon duartrokitje.

Për urtësinë që nuk matet me poste.

Sepse ka një lloj pushteti që nuk fitohet me vota dhe nuk ushtrohet me dekrete.

Është pushteti i karakterit.

I edukimit.

I shembullit.

I dashurisë.

Është fuqia e grave.

Një fuqi që nuk bën zhurmë, por që shpesh ndryshon rrjedhën e historisë.



LAERT RAMADANI

(1982–2026)



Një ushtarak që e jetoi uniformën me dinjitet

Ka ikje që lënë boshllëk. Ka njerëz që largohen para kohe, por mbeten përgjithmonë në kujtesën e atyre që i njohën, punuan dhe shërbyen krah tyre.

Me hidhërim të thellë morëm lajmin e ndarjes nga jeta të Laert Ramadani, ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i cili, pas një beteje të vështirë me një sëmundje të rëndë, u nda nga jeta në moshën 44-vjeçare.

I lindur në Piskovë të Përmetit, Laerti zgjodhi që në rininë e tij t'i përkushtohej shërbimit ndaj atdheut. Për shumë vite ai veshi me krenari uniformën ushtarake, duke e ushtruar detyrën me profesionalizëm, disiplinë dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie. Gjatë karrierës së tij, ai mori pjesë edhe në misione ndërkombëtare, duke përfaqësuar me dinjitet Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe flamurin kombëtar.

Për kolegët ishte një ushtarak i përkushtuar, për eprorët një profesionist i besueshëm, ndërsa për miqtë një njeri i thjeshtë, i ndershëm dhe gjithmonë i gatshëm të ndihmonte. Vlerat e tij njerëzore shkonin përtej detyrës; ato pasqyronin karakterin e një njeriu që besonte te shërbimi, përgjegjësia dhe respekti për të tjerët. Por mbi të gjitha, Laerti ishte një njeri i familjes. Bashkëshort, baba i përkushtuar i tre fëmijëve, dy vajzave dhe një djali, ai ëndërronte të ardhmen e tyre dhe punonte çdo ditë për t'u lënë shembullin e ndershmërisë, punës dhe dashurisë për vendin.

Largimi i tij i parakohshëm është një humbje e madhe për familjen, për miqtë, për kolegët dhe për komunitetin ushtarak. Ai largohet fizikisht, por kujtimi i tij do të mbetet i gjallë në zemrat e të gjithë atyre që patën fatin ta njihnin dhe të ndanin me të vitet e shërbimit.

Në jetën ushtarake medaljet dhe gradat kanë rëndësinë e tyre, por janë karakteri, përkushtimi dhe mënyra se si kujtohesh nga njerëzit ato që lënë gjurmën më të thellë. Këtë trashëgimi lë pas Laert Ramadani.

Redaksia e gazetës "Ushtria", në emër të komunitetit të shtypit ushtarak, shpreh ngushëllimet më të singerta për ndarjen e parakohshme nga jeta të ushtarakut Laert Ramadani.

Në këto çaste të dhimbshme, jemi pranë bashkëshortes, tre fëmijëve, prindërve, të afërmeve, miqve dhe kolegëve të tij të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, duke ndarë me ta dhimbjen për këtë humbje të rëndë.

I LINDUR NË PISKOVË TË PËRMETIT, LAERTI ZGJODHI QË NË RININË E TIJ T'I PËRKUSHTOHEJ SHËRBIMIT NDAJ ATDHEUT. PËR SHUMË VITE AI VESHI ME KRENARI UNIFORMËN USHTARAKE, DUKE E USHTRUAR DETYRËN ME PROFESIONALIZËM, DISIPLINË DHE NDJENJË TË LARTË PËRGJEGJËSIE. GJATË KARRIERËS SË TIJ, AI MORI PJESË EDHE NË MISIONE NDËRKOMBËTARE, DUKE PËRFAQËSUAR ME DINJITET FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FLAMURIN KOMBËTAR.

Qoftë i përjetshëm kujtimi i tij dhe i lehtë i qoftë dheu.

Prehu në page, Laert!



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Kaçe Starova – luftëtarja, nusja e maleve

Në historinë e lëvizjes kombëtare shqiptare nuk kanë mbetur në kujtesë vetëm burrat që morën armët për liri. Krahës tyre qëndrojnë edhe gra të rralla, të cilat sfiduan zakonet e kohës dhe u bënë pjesë e luftës për çlirimin e vendit. Një ndër figurat më të veçanta është Kaçe Starova, gruaja që populli e quajti me të drejtë “nusja e maleve”, sepse zgjodhi pushkën para rehatisë së shtëpisë dhe jetën e çetës para jetës së zakonshme familjare.

Kaçe Starova lindi në fshatin Starovë të Pogradecit, në vitin 1858, në një familje me tradita të spikatura atdhetare. Që në moshë të re u edukua me dashurinë për vendin, me ndjenjën e drejtësisë dhe me frymën e qëndresës kundër sundimit osman. Ajo ishte e njohur për bukurinë, zgjuarsinë, trimërinë dhe bujarinë e saj, cilësi që më vonë do ta bënin një nga gratë më të respektuara të krahinës.

Fati e lidhi me një nga kapedanët më të njohur të Pogradecit, Kajo Ibrahim Zere (Babjeni), i lindur në Babjen, në vitin 1843. Emrin e fshatit të tij ai e bëri mbiemër, duke e kthyer atë në simbol të trimërisë. Që në moshën pesëmbëdhjetëvjeçare ai iu bashkua çetës së dajës së tij, Shahin Matrakut, një tjetër figurë e njohur e rezistencës shqiptare. Për dekada me radhë Kajo Babjeni luftoi në malet e Gorës, Mokrës dhe Oparit, duke u bërë një nga prijësit më të njohur të lëvizjes kaçake dhe kombëtare.

Pas humbjes së bashkëshortes së parë, Kajo u martua me Kaçe Starovën. Kjo martesë nuk ishte një bashkim i zakonshëm familjar, por një aleancë e vërtetë lufte. Tradita popullore rrëfen se Kaçja nuk solli në pajë vetëm rrobat dhe stollitë e një nuseje, por edhe armën e saj. Dasma u zhvillua thjesht, ndërsa krushqit ishin luftëtarët e çetave të Gorës, Mokrës e Oparit.

Kur dikush i tha Kajos:

-“Ke marrë nuse të mire”, ai u përgjigj:

-“Po, por jo nuse për punët e shtëpisë; kam marrë një nuse për në mal.”

Kjo thënie mbeti pjesë e kujtesës popullore dhe përmbledh më së miri karakterin e Kaçes.

Liria, misioni i jetës

Që nga dita e martesës, lufta për lirinë u bë misioni i jetës së saj. Ajo nuk u nda më nga burri, duke e shoqëruar në marshime, në pritë, në betejat dhe në të gjitha rreziqet që sillte jeta e kaçakëve. Në një kohë kur prania e grave në formacionet luftarake ishte tepër e rrallë, Kaçja fitoi respektin e bashkëluftëtarëve si një luftëtare e barabartë me burrat.

Çetat patriotike të Gorës, Mokrës dhe Oparit kishin krijuar një mënyrë të organizuar veprimi. Ato mbështeteshin nga popullsia vendëse, e cila i strehonte, i furnizonte me ushqime dhe u jepte njoftime për lëvizjet e forcave osmane. Kapedan Kajo Babjeni kërkonte disiplinë të hekurt, sjellje shembullore ndaj popullit dhe respekt pa dallim feje apo krahine. Këto parime u bënë edhe parimet e Kaçe Starovës.

Emri i çiftit luftëtar u përhap shpejt në gjithë krahinën e Pogradecit. Kaçja mori pjesë në veprimet luftarake të viteve 1887-1888, kur çeta e Kajos mbante tashmë edhe flamurin kombëtar shqiptar. Ajo luftoi edhe në Malin e Thatë në vitin 1899 dhe mori pjesë në shumë aksione të tjera të organizuara nga çetat patriotike.

Një episod domethënës i jetës së tyre ishte takimi me Gjerasim Qiriazin, të cilit Kajo dhe Kaçja i kërkuan falje për

Një nuse për në mal, një jetë për Shqipërinë: Kaçe Starova - Gruaja që sfidoi kohën dhe hyri në histori



pengmarrjen e dikurshme, pasi kishin kuptuar se veprimi ishte kryer mbi bazën e informacioneve të gabuara. Ky gjest dëshmon ndershmërinë morale të kapedanit dhe të bashkëluftëtares së tij.

Jeta e tyre ishte një jetë pa shtëpi të përhershme. Konakët e tyre ishin shtëpitë e patriotëve, kishat, teqetë dhe odat e fshatarëve. Në Voskopojë strehoheshin në Kishën e Shën Prodhomit; në Podkozhan gjenin mbështetje në Kishën e Shën Premtes, në Kishën e Shën Mitrit dhe në shtëpinë e patriotit Jani Bitro, ku funksiononte edhe “Klubi Patriotik i Mokrës”. Këto baza shërbyen për organizimin e shumë veprimeve patriotike.

Më 28 korrik 1912, çetat e Gorës dhe Mokrës marshuan drejt Pogradecit me flamurin kombëtar në ballë. Në krah të Kajo Babjenit ishte edhe Kaçe Starova, e cila konsiderohet ndër gratë e para shqiptare që morën pjesë me armë në dorë në çetat patriotike të kësaj treve.


Sipas traditës gojore, ajo e shoqëroi Kajon edhe në udhëtimin drejt Vlorës, ku përfaqësuesit e krahinës morën pjesë në ngjarjet historike të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë.

Luftë ndaj andartëve

Në vjeshtën e vitit 1913, forcat andarte greke rrethuan shtëpinë e Kajo Babjenit në Babjen. Brenda ndodheshin Kajo, Kaçja dhe disa luftëtarë të çetës. Luftimet vazhduan për më shumë se gjashtë orë. Në fund çeta arriti të çante rrethimin pa humbje, ndërsa nga pala sulmuese mbetën të vrarë disa ushtarë dhe një oficer. Si hakmarrje, andartët dogjën shtëpinë e kapedanit dhe arrestuan disa banorë të pafajshëm.

Kjo ngjarje u përjetësua edhe në këngën popullore:

“O Kajo, o burrë i gjatë,
Me mauzer i veshe gratë,



Luftove ditë e natë...”

Më 2 prill 1914, Kajo Babjeni kontribuo edhe në shpëtimin e shkollës shqiptare dhe të mësueses Sevasti Qiriazit nga zjarrvënja e andartëve grekë. Pas djegies së shtëpisë së tij, patriotët shqiptarë brenda dhe jashtë vendit organizuan ndihma financiare për rindërtimin e saj. Veçanërisht domethënës ishte ndihmesa e kolonisë shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e cila mblodhi fonde për kapëdinin, një dëshmi e respektit që gëzonte figura e tij.

Kaçe Starova nuk pati fëmijë. Megjithatë, ajo la pas një trashëgimi shumë më të madhe se një familje: la shembullin e një gruaje që zgjodhi sakrificën, lirinë dhe dinjitetin kombëtar. Emri i saj mbeti i lidhur përgjithmonë me figurën e Kajo Babjenit dhe me historinë e rezistencës shqiptare në trevat e Pogradecit. Pas vdekjes së Kajo Babjenit në vitin 1923, Kaçja vazhdoi të ruante kujtimin e tij, të mbështeste ish-luftëtarët e çetës dhe të gëzonte respektin e popullit. Ajo u nda nga jeta në vitin 1934, në moshën 78-vjeçare.

Realizuan misionin për mbrojtjen e atdheut

Sot, të dy prehen në Babjen, pranë njëri-tjetrit. Varret e tyre janë të thjeshta, por emrat që mbajnë kanë hyrë në kujtesën historike të krahinës. Kaçe Starova mbetet një nga figurat më përfaqësuese të grave shqiptare që nuk e panë luftën si detyrë vetëm të burrave, por si një mision të përbashkët për mbrojtjen e atdheut.

Ajo mbajti emrin e një luleje pranverore dhe, ashtu si ajo lule, solli shpresë në kohë të vështira. Në jetën e saj u bashkuan butësia e gruas, fisnikëria e njeriut dhe trimëria e luftëtares. **Prandaj, historia e Kaçe Starovës nuk është vetëm historia e bashkëshortes së një kapedani, por historia e një heroine popullore që e shkriu jetën me idealin e lirisë.**

Deepfake, iluzioni q  sfidon t  v rtet n

Teknologjia e “deepfake”, video apo imazhe t  manipuluar  p rmes inteligjenc s artificiale, ka fituar nj  reputacion t  friksh m. Nga fjalimet e rreme politike, te pamjet e fabrikuar  q  synojn  t  mashtrojn  publikun, shembujt e p rdorimit t  saj p r keq jan  t  shumt . Por a mund t  p rdoret e nj jta teknologji p r t  mir n e shoq ris ? Kjo  sht  pyetja q  projekti european SOLARIS, i financuar nga BE, u p rpoq t  zb rthente.

Kur iluzioni b het realitet

Koordinatorja e projektit, Federica Russo nga Universiteti i Utrecht-it, e pranon se nisja e studimit u mb shtet mbi nj  dyshim: “Kur filluam, e dinim q  mediat sintetike mund t  ishin t  d mshme. Por donim t  kuptonim n se mund t  kishin edhe potencial pozitiv”.

Eksperimentet e SOLARIS treguan se manipulimi nuk ka nevoj  t  jet  perfekt p r t  qen  bind s. N  nj  studim me mbi 1 100 pjes marr s n  Itali, Slloveni dhe Mbret rin  e Bashkuar, njer zit u vun  p rball  videove reale dhe t  gjeneruara nga AI-ja, me figura t  njohura si Greta Thunberg, Donald Trump, Justin Trudeau apo Viktor Orb n. Rezultati? Edhe versionet me cil si t  dob t arrit n t  mashtrojn  nj  pjes  t  konsiderueshme t  publikut. Dhe m  shqet suesja: njer zit ishin m  pak kritik  kur mesazhi p rputhej me bindjet e tyre politike.

Gazetar t n  prov 

Nj  pjes  e r nd sishme e projektit u zhvillua n  bashk punim me agjencin  italiane t  lajmeve ANSA. Gazetar t u vendos n p rball  skenar ve t  fabrikuar, nga njoftime politike t  rreme te incidente publike t  sajua, p r t  par  si do t  reasonin n n presionin e redaksis .

Surpriza ishte se reporter t nuk u fokusuan tek detajet teknike t  fytyr s apo sinkronizimit t  buz ve, por tek konteksti: a kishte kuptim historia? A e kishin konfirmuar burimet e besueshme? Ku ishte publikuar videoja? Ky ushtrim nxori n  pah se verifikimi gazetaresk mbetet nj  mburoj  e fort  kund r manipulimit, por edhe se lajmet e rreme qarkullojn  me shpejt si dhe korrigjimi i tyre shpesh nuk arrin t  ndryshoj  p rshtypjen e par .

Deepfake p r t  mir n

SOLARIS nuk u ndal vet m tek rreziqet. N  bashk punim me qytetar  europian , ekipi krijoi p rmbajtje sintetike mbi tema sociale si sh ndeti mendor, nd rgjegj simi p r klim n dhe roli i grave n  shkenc . Nj  shembull i veçant  ishte nj  video ku shfaqej Marie Sklodowska-Curie duke folur p r trash gimin  e saj.

Reagimet e pjes marr sve treguan se njer zit i besojn  m  shum  historive reale dhe t  af rta, sesa mesazheve abstrakte. Por dilemat etike nuk munguan: a  sht  e pranueshme t  rikrijosh figura historike? Sa transparenc  duhet t  ket  mbi autor sin  e p rmbajtjes? “ sht  m  e v shtir  sesa mendonim t  krijosh nj  deepfake p r t  mir n”, pranon Russo. P r ket  arsye, projekti vendosi t  mos publikoj  asnj  nga videot e prodhuara, p r t  mos rrezikuar keqp rdorimin.

P rtej teknologjis 

Nj  m sim i madh i nxjerr  nga SOLARIS  sht  se mjetet teknike p r zbulimin e deepfake-ve nuk mjaftojn . Nevojitet nj  kombinim i gazetaris  profesionale, rregullimit ligjor, nd rgjegj simit publik dhe pjes marrjes s  qytetar ve. Vet m k shtu mund t  p rcaktohet n se kjo teknologji do t  sh rbej  si arm  e manipulimit apo si instrument p r angazhim demokratik.

Statistikat e Deepfake AI p r vitin 2026

Shkalla dhe trajektorja e k rc nimeve nga inteligjenca artificiale e bazuar n  “deepfake” pasqyrohen n  t  dh nat aktuale t  industris .

Sipas raportit t  Signicat “The Battle Against AI-Driven Identity Fraud” (2025), p rpjekjet p r mashtrime p rmes deepfake jan  rritur me 2 137 % gjat  tre viteve t  fundit, duke u rritur nga 0.1 % n  6.5 % t  t  gjitha tentativave t  regjistruara p r mashtrim. Ky zhvillim lidhet me p rparimin e shpejt  t  aft sive t  k rc nimeve t  drejtuara nga AI n  ket  periudh .

Raporti i Entrust “Identity Fraud Report 2025” tregon se sulmet p rmes deepfake ndodhin  do pes  minuta, duke e b r  ket  nj  k rc nim aktiv dhe t  p rhapur, jo m  nj  fenomen n  zhvillim. Kjo e vendos parandalimin e mashtrimeve mes p rpar sive kryesore t  ekipeve t  siguris  n  mbar  bot n.

Efektiviteti i k tyre sulmeve e shton shqet simin. Sipas raportit Cisco Talos Incident Response Q1 2025, vishing (phishing p rmes telefonit)  sht  forma m  e zakonshme e sulmeve t  phishing, e pranishme n  mbi 60 % t  rasteve t  analizuar.

Raporti i Verizon “Data Breach Investigations Report 2025” tregon se elementi njer zor ishte faktor n  60 % t  t  gjitha shkeljeve t  t  dh nave, duke theksuar se  do strategji e plot  e siguris  kibernetike duhet t  adresoj  dob sit  njer zore, p rshir  ndjeshm rin  ndaj phishing-ut dhe manipulimit social.

N  aspektin e tregut, sipas Marketsandmarkets “Deepfake AI Report 2024”, tregu global i deepfake AI pritet t  arrij  n  5.13 miliard  dollar  deri n  vitin 2030, me nj  rit m rritjeje vjetore t  p rb r  (CAGR) prej 44.5 %.

Industrit  m  t  goditura nga sulmet Deepfake

Kriminel t kibernetik  zgjedhin objektivat bazuar n  kombinimin e p rfitimit financiar dhe kushteve operative q  leht sojn 



manipulimin social. Sektor t m  t  prekur jan :

Sh rbimet financiare: Objektivi kryesor p r shkak t  mund sis  s  fitimit direkt. Sulmet p rfshijn  imitimin e drejtuesve p r t  autorizuar transferta t  rreme.

Sh ndet sia: Mjedise me presion t  lart  dhe t  dh na t  ndjeshme t  pacient ve;  do nd rprerje mund t  ket  pasoja kritike.

Teknologjia: Ritmi i shpejt  i pun s dhe komunikimi i larg t e b jn  sektorin ve an risht t  cenuesh m ndaj imitimit p rmes video apo audio.

Prodhimi: Sisteme t  nd rlidhura dhe lokacione t  decentralizuara rrisin rrezikun e mashtrimeve p rmes komunikimit.

Juridiku: Firmat ligjore trajtojn  informacione konfidenciale; imitimi i avokat ve apo klient ve mund t   oj  n  rrjedhje t  dh nash t  ndjeshme.

Shitja me pakic : Sip rfaqe e madhe sulmi p r shkak t  numrit t  lart  t  punonj sve dhe bashk punimeve me pal  t  treta.

Arsimi: Mjedise t  hapura dhe bashk punuese; sulmet shpesh synojn  student t, imazhet e t  cil ve jan  leht sisht t  disponueshme n  rrjete sociale.

Roli i individit  sht  po aq i r nd sish m sa klasifikimi i industris  n  vler simin e rrezikut nga sulmet deepfake.

Format kryesore t  Deepfake AI

Audio deepfakes: Z ra t  sintetizuar q  imitojn  individ  real , p rdorur p r mashtrime telefonike apo urdhra t  rrem .

Video deepfakes: Pamje t  gjeneruara q  tregojn  dik  duke th n  apo b r  di ka q  nuk ka ndodhur.

Face-swapping: Nd rrimi i fytyr s s  nj  personi me nj  tjet r n  video ekzistuese.

Lip-sync deepfakes: Ndryshimi i l vizjeve t  buz ve p r t  p rthuhur me audio t  fabrikuar.

Deepfake overlays: Manipulim n  koh  reale i pamjes gjat 

video-thirrjeve, duke lejuar imitimin pa p rmbajtje t  regjistruar.

Image deepfakes: Imazhe statike t  gjeneruara p r t  mb shtetur mashtrime, shpesh n  fushata phishing.

Live deepfakes: Teknologji q  imiton pamjen e dikujt n  koh  reale, duke e b r  t  rrezikshme p r sulme t  synuara ndaj individ ve me pozita t  larta.

Pse deepfake  sht  i rreziksh m n  vitin 2026

Realiz m i lart : Teknologjia ka arritur nj  pik  ku p rmbajtja sintetike duket aq bind se sa mund t  shtyj  njer zit t  nd rmarrin veprime konkrete, jo thjesht t  habiten n  rrjete sociale.

Shfryt zimi i psikologjis  njer zore:

Urgjenca – krijohen skenar  q  duken si k rkesa t  menj hershme, duke ulur aft sin  p r t  menduar kritikisht.

Autoriteti – p rdoret imazhi ose z ri i figurave t  besueshme p r t  dh n  legjitimitet k rkeseve mashtruese.

Inputi shqisor – njer zit jan  m  skeptik  ndaj tekstit, por vazhdojn  t  besojn  pamjet dhe tingujt. Deepfake e shfryt zon ket  besim t  rr njosur.

Dezinformim publik: Mund t  manipuloj  opinionin shoq ror dhe politik.

Mashtrime financiare: P rdoret p r t  imituar drejtues ose persona t  besuar p r t  autorizuar transferta t  rreme.

Abuzim personal: Shp rndarja e imazheve t  fabrikuar  pa p lqimin e individ ve d mton reputacionin dhe privat sin .

Dob simi i besimit: Kur njer zit nuk jan  t  sigurt n se nj  video apo audio  sht  e v rtet , vet  besimi tek informacioni publik fillon t  l kundet.

Pra, rreziku i deepfake nuk lidhet vet m me nj  industri apo profesion, por me faktin q  prek  do njeri dhe  do fush  ku komunikimi vizual e auditiv ka rol vendimtar. N  vitin 2026, kjo teknologji  sht  b r  nj  mjet i fuqish m manipulimi q  k rkon nd rgjegj sim, rregullim dhe verifikim t  vazhduesh m.

NATO hap një kapitull të ri në operacionet hapësinore të aleancës

Aleatët e NATO-s hapën një fazë të re në bashkëpunimin hapësinor, duke prezantuar nisma dhe partneritete të përbashkëta për zhvillimin e kapaciteteve të reja satelitore. Në Forumin e Industrisë së Mbrojtjes të Samitit të NATO-s në Ankara, tetë vende aleate nisën projektin e ri shumëkombësh HALO – Hybrid Alliance Layered Operations in Space, i cili synon të përmirësojë lidhjen dhe integrimin e satelitëve ushtarakë kombëtarë në një mega-konstelacion të rrjetëzuar. Ky sistem do të rrisë qëndrueshmërinë e aleancës dhe avantazhin e saj ushtarak në hapësirë, duke mundësuar komunikime me shpejtësi të lartë, inteligjencë të avancuar dhe gjurmim raketor. HALO do të kapërcejë kufizimet e kostos, kohës dhe mbulimit që karakterizojnë flotat satelitore të drejtuara nga një vend i vetëm.

Në të njëjtin forum, disa vende anëtare njoftuan kontribute të rëndësishme për mbrojtjen në dhe nga hapësira. Kanadaja u bë anëtar i 15-të i nismës shumëkombëshe STARLIFT, e cila eksploron mënyra për të krijuar një rrjet kapacitetesh lëshimi që do t'i mundësojë aleatëve të vendosin asete në orbitë me njoftim të shkurtër nga hapësirë-portet e aleancës. Kjo do të forcojë aftësinë e NATO-s për të reaguar më shpejt ndaj kërcënimeve që vijnë nga hapësira. Ndërkohë, kompania gjermane “Isar Aerospace” nënshkroi një kontratë me “Maritime Launch Services” të Kanadasë për të siguruar akses në infrastrukturën e lëshimit në “Spaceport Nova Scotia”, duke përmirësuar gatishmërinë e saj orbitale.

Spanja u bë vendi i 19-të që iu bashkua nismës “Alliance Persistent Surveillance from Space” (APSS), investimi më i madh shumëkombësh në historinë e NATO-s për kapacitete hapësinore. Kontributi i saj do të përqendrohet në rritjen e survejimit bregdetar përmes imazheve nga satelitët e konstelacionit “Atlantic Constellation”.

Duke ndjekur suksesin e satelitit të parë të vëzhgimit të Tokës IMECE, Turqia shpalli një plan ambicioz për zhvillimin e dy satelitëve të rinj me rezolucion të lartë, që do të plotësojnë kapacitetet e forta hapësinore në rajon. Përveç kësaj, Ankaraja po investon në satelitë të orbitës së ulët për komunikime ushtarake dhe në zhvillimin e sistemeve të radarëve të paralajmërimit të hershëm, të cilat do të ndihmojnë në ruajtjen e lidhjes dhe sigurisë së vendit në fushëbetejë.

Nisma e tetë vendeve aleate për krijimin e konstelacionit satelitor HALO shënon një pikë kthese në mënyrën se si NATO e koncepton hapësirën si fushë operationale. Deri më tani, satelitët kombëtarë kanë funksionuar si sisteme të veçuara, shpesh të kufizuara në kapacitetin e tyre për të përballuar sulme kibernetike, jamming apo shkatërrim fizik. HALO synon ta tejkalojë këtë fragmentim duke i integruar këto sisteme në një rrjet të përbashkët, ku secili satelit bëhet pjesë e një ekosistemi më të madh, të aftë të sigurojë komunikime të shpejta, gjurmim raketor dhe inteligjencë të avancuar. Ky model i ri i arkitekturës hapësinore është i ngjashëm me kalimin nga rrjetet lokale në internetin global: një transformim që rrit fuqinë, shpejtësinë dhe rezistencën e sistemit.



HALO si një arkitekturë e re hapësinore për transformimin e operacioneve ushtarake dhe teknologjike të NATO-s

Rëndësia e integritetit teknologjik dhe sigurisë kolektive në hapësirë

HALO nuk është thjesht një projekt satelitor, por një platformë teknologjike e sigurisë kolektive. Duke i lidhur flotat kombëtare në një rrjet të përbashkët, NATO krijon një sistem ku humbja e një sateliti nuk e paralizon operacionin, pasi rrjeti mund të ridrejtojë trafikun përmes satelitëve të tjerë. Kjo rrit ndjeshëm rezistencën ndaj sulmeve kibernetike dhe ndërhyrjeve elektronike, duke e bërë komunikimin më të sigurt dhe më të besueshëm. Për më tepër, HALO do të ketë kapacitetin të përpunojë sasi të mëdha të dhënash në kohë reale, duke mundësuar një reagim më të shpejtë ndaj kërcënimeve balistike dhe duke ofruar paralajmërim të hershëm për aleatët. Në këtë mënyrë, hapësira po shndërrohet në një shtresë të re të mbrojtjes kolektive, ku teknologjia është po aq e rëndësishme sa forcat tokësore, detare apo ajrore.

Kontributet kombëtare dhe diversiteti teknologjik si bazë e suksesit

Tetë vendet pjesëmarrëse – Danimarka, Kanadaja,

Finlanda, Gjermania, Norvegjia, Holanda, Suedia dhe Turqia – sjellin secila ekspertizën e vet teknologjike dhe kapacitetet kombëtare. Ky diversitet është një nga pikat më të forta të projektit, pasi kombinimi i teknologjive të ndryshme krijon një sistem më të pasur dhe më të qëndrueshëm. Për shembull, Kanadaja ka përvojë të gjatë në fushën e satelitëve të komunikimit, ndërsa Gjermania dhe Suedia sjellin kapacitete të avancuara në sensorë dhe imazheri. Turqia, nga ana tjetër, ka shpallur zhvillimin e dy satelitëve të rinj me rezolucion të lartë, duke forcuar kapacitetet rajonale. Ky bashkëpunim i shumëfishtë e bën HALO një projekt unik, ku teknologjitë kombëtare nuk konkurrojnë, por bashkëpunojnë për të krijuar një sistem të përbashkët.

Lidhja e HALO me nisma të tjera hapësinore të NATO-s dhe vizioni i ardhshëm

HALO është pjesë e një mozaiku më të madh të nismave hapësinore të NATO-s. Kanadaja u bë anëtar i 15-të i STARLIFT, një projekt që synon krijimin e një rrjeti hapësirë-portesh për lëshime të shpejta dhe të koordinuara. Spanja, ndërkohë, u bashkua me Alliance Persistent Surveillance from Space, duke ofruar imazhe nga satelitët e saj “Atlantic Constellation” për survejim bregdetar. Këto nisma tregojnë se NATO po ndërton një ekosistem hapësinor, ku HALO është shtylla kryesore e komunikimit dhe integritetit, ndërsa projektet e tjera mbështesin kapacitetet e lëshimit dhe survejimit. Në të ardhmen, ky ekosistem mund të evoluojë drejt përdorimit të inteligjencës artificiale për analizë të të dhënave në kohë reale, komunikimeve kuantike për siguri të pakrahasueshme dhe teknologjive të reja të propulsioneve për satelitë më fleksibël.

HALO si faktor gjeopolitik dhe balancë e fuqisë në hapësirë

Përtej dimensionit teknologjik, HALO ka një ndikim të madh gjeopolitik. Hapësira është bërë një arenë e konkurrencës globale, ku fuqitë e mëdha si Rusia dhe Kina po investojnë në sisteme satelitore për komunikim, survejim dhe mbrojtje raketore. Me krijimin e HALO, NATO jo vetëm që rrit kapacitetet e saj teknologjike, por edhe dërgon një mesazh të qartë se aleanca është e gatshme të mbrojë interesat e saj në hapësirë. Ky projekt mund të ndryshojë balancën e fuqisë, duke e bërë NATO-n më të aftë të përballojë sfidat e reja dhe të ruajë avantazhin strategjik në një epokë ku hapësira po bëhet po aq e rëndësishme sa tokat dhe oqeanet.





STUDIO NË AKADEMITË PRESTIGJIOZE USHTARAKE TË TURQISË

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë hapin aplikimet për studime të larta ushtarake në Republikën e Turqisë

Qendra e Personel Rekrutimit njofton të gjithë të rinjtë e interesuar se janë hapur aplikimet për përfitimin e 4 (katër) kuotave të studimit në institucionet e arsimit të lartë ushtarak të Republikës së Turqisë, për vitin akademik 2026.

Kuotat e studimit janë si më poshtë:

- 1 kuotë – Shkolla e Lartë Ushtarake e Forcës Tokësore
- 1 kuotë – Shkolla e Lartë Ushtarake e Forcës Detare
- 1 kuotë – Shkolla e Lartë Ushtarake e Forcës Ajrore
- 1 kuotë – Fakulteti i Mjekësisë “Gülhane”

Kjo është një mundësi e shkëlqyer për të rinjtë shqiptarë që synojnë një karrierë profesionale në Forcat e Armatosura dhe dëshirojnë të formohen në një nga sistemet më të avancuara të arsimit ushtarak.

Afati i aplikimit

Dokumentacioni duhet të dorëzohet pranë Qendrës së Personel Rekrutimit deri më

17 gusht 2026.

Mos e humb këtë mundësi!

Ndërto të ardhmen tënde në Forcat e Armatosura, studio në akademitë ushtarake të Republikës së Turqisë dhe bëhu pjesë e elitës së oficerëve të së nesërmes.

Për informacion të mëtejshëm dhe procedurat e aplikimit, drejtohuni pranë Qendrës së Personel Rekrutimit ose strukturave të rekrutimit të Forcave të Armatosura.